

**PARASHIKIMET PËR
POPULLSINË E SHQIPËRISË
2001-2021**

No part of this publication can be reproduced or transmitted in any form or by any means without the prior written permission of the copyright holder.

Copyright © INSTAT 2004



Instituti i Statistikes
Rr. Lek Dukagjini, Nr.5, Tirane
Tel: +355 4 222411/230484
Fax: +355 4 228300
E-mail: botim_difuzion@instat.gov.al
www.instat.gov.al

ISBN 99927-973-8-X

Nxjerrja e kësaj serie studimesh me karakter social përbën një moment i rëndësishëm në jetën profesionale të INSTAT.

Informacioni i mbledhur gjatë Regjistrimit të Popullsisë dhe Banesave 2001 si dhe të dhënat e Anketës së Matjes së Nivelit të Jetesës 2002, u përdorën si burime kryesore të dhënash për të analizuar fenomene të tilla si migracioni i dekadës së fundit, lëvizja e brendshme e popullsisë, gjendja e tregut të punës, impakti që kanë keto çështje në jetën e grave dhe burrave, në problemet e pabarazisë dhe të situatës së nivelit të jetesës, si dhe u përdor në projeksionet e popullsisë për periudhën 2001-2021.

Këto studime kanë rëndësi të veçantë për hartuesit e politikave dhe për hulumtues të disiplinave të ndryshme. Ato mund të përdoren për të kuptuar se si duhet të punohet për zbutjen e pabarazisë, si mund të investohet në infrastrukturën e shërbimeve, se si mund të ndihmojhet autoritetet lokale për të hartuar politika të veçanta për grupet në nevojë.

Studimet gjithashtu hedhin dritë edhe në situatën e objektivave të mileniumit në Shqipëri dhe japin më shumë elemente për monitorimin e tyre të vazhdueshëm.

Këto studime janë fryt i bashkëpunimit disamujor të ekspertëve ndërkombëtarë dhe ekspertëve lokale. Gjithashtu ato janë edhe dëshmi e një rrjeti lokal studiuesish që fillon të bashkëpunojë me INSTAT, në analizimin e fenomeneve sociale.

INSTAT përfiton nga ky rast për të falenderuar të Agjencinë Zviceriane për Zhvillim dhe Bashkëpunim, Zyrën për Bashkëpunim dhe Zhvillim të Italisë, të cilët mbështeten dhe koordinuan punën për kryerjen e këtyre botimeve.

Milva Ekonomi

General Director

1	METODAT DHE SUPOZIMET	9
----------	------------------------------	----------

1.1	Metodat e parashikimit	9
1.2	Supozimet për nivelet dhe tendencat e ardhshme	11
1.2.1	Vdekshmëria	11
1.2.2	Lindshmëria	12
1.2.3	Migracioni	14
1.3	Seria e parashikimeve të popullsisë	17
1.4	Konkluzione	18

2	REZULTATET KRYESORE DHE ANALIZA	27
----------	--	-----------

2.1	Popullsia e përgjithshme dhe rritja e saj (2001-2021)	27
2.1.1	Popullsia shqiptare në 2021	27
2.1.2	Roli i emigracionit, lindshmërisë dhe vdekshmërisë	28
2.1.3	Rritja e popullsisë dhe faktorët e saj	30
2.1.4	Popullsia dhe rritja e saj në të ardhshmen: një vështrim i përgjithshëm	31
2.2	Popullsia sipas Moshës	31
2.2.1	Popullsia në grupmoshat e mëdha	31
2.2.2	Piramidat e moshës	32
2.2.3	Çështje specifike që lidhen me moshën	34
2.2.4	Një vështrim për përbërjen e ardhshme të moshës	35
2.3.	Popullsia në Rajone	35
2.3.1	Popullsia e përgjithshme dhe rritja e popullsisë	35
2.3.2	Popullsia sipas moshës	37
2.4	Përzgjedhjet ndër Grupet e Parashikimeve të Popullsisë	39
2.4.1	Parashikimet e popullsisë kombëtare	39
2.4.2	Parashikimet e popullsisë së rretheve	41

3	REZULTATET E PROJEKSIONEVE TË POPULLSISË (2001- 2021)	43
----------	--	-----------

TABELAT DHE GRAFKËT

Tabela 1: Tregues të lindshmërisë sipas rretheve dhe rajoneve	14
Tabela 2: Migracioni i brendshëm sipas rretheve dhe rajoneve. Meshkuj	15
Tabela 3: Migracioni i brendshëm sipas rretheve dhe rajoneve. Femra	16
Tabela 4: Koeficientët e emigracionit sipas rajoneve dhe grup-moshave 2000 - 2001	17
Tabela 5: Koeficientët specifikë të vdekshmërisë të moshës 0 deri 89. Projeksionet e Shqipërisë sipas periudhave	19
Tabela 6: Te mbijetuarit në tabelat e vdekshmërisë. Projeksionet e Shqipërisë dhe Rajoneve sipas periudhave	21
Tabela 7: Koeficientët specifikë të lindshmërisë. Projeksionet, Shqipëria për vitet (2001-2010). Lindshmëri e lartë	22
Tabela 8: Koeficientët specifikë të lindshmërisë. Projeksionet, Shqipëria për vitet (2001-2010). Lindshmëri e ulët	24
Tabela 9: Koeficientët specifikë të lindshmërisë(*5) sipas Rajoneve. Projeksionet e Shqipërisë, sipas periudhave	26
Tabela 10: Mundësia e emigracionit nga vendi dhe nga rajonet. Projeksionet e Shqipërisë, sipas periudhave	26
Tabela 11: Projeksionet e Popullsisë së Shqipërisë. Popullsia gjithsej për çdo vit sipas hipotezave (supozimeve) të ndryshme	28
Tabela 12: Projeksionet e Popullsisë për Rajonet e Shqipërisë Popullsia gjithsej çdo 5 vjet dhe shpërndarja sipas rajoneve	36
Tabela 13: Projeksionet e Popullsisë për Rajonet e Shqipërisë. Shpërndarja sipas grup-moshave të mëdha	38
Tabela 14: Vdekshmëri e lartë – Lindshmëri e ulët – Pa migracion	43
Tabela 15: Vdekshmëri e lartë – Lindshmëri e ulët – Migracion i jashtëm	59
Tabela 16: Vdekshmëri e lartë – Lindshmëri e lartë – Pa migracion	75
Tabela 17: Vdekshmëri e lartë – Lindshmëri e lartë – Migracion i jashtëm	91
Tabela 18: Vdekshmëri e ulët – Lindshmëri e ulët – Pa migracion	95
Tabela 19: Vdekshmëri e ulët – Lindshmëri e ulët – Migracion i jashtëm	99
Tabela 20: Vdekshmëri e ulët – Lindshmëri e lartë – Pa migracion	103
Tabela 21: Vdekshmëri e ulët – Lindshmëri e lartë – Migracioni i jashtëm	107
Tabela 22: Projeksionet e Popullsisë sipas Rajoneve	111
<hr/>	
Figura 1: Probabiliteti i vdekshmërisë sipas gjinisë dhe moshës, Shqipëria 2000-2001 & Italia 1977	11
Figura 2: Koeficientet specifikë të lindshmërisë	13
Figura 3: Projeksionet e Popullsisë së Shqipërisë	29
Figura 4: Projeksionet e Popullsisë së Shqipërisë Koeficientët e rritjes vjetore sipas supozimeve të ndryshme	29
Figura 5: Projeksionet e Popullsisë së Shqipërisë Struktura moshore sipas supozimeve të ndryshme	31
Figura 6: Projeksionet e Popullsisë së Shqipërisë Piramidat e moshës në 2021 sipas supozimeve të ndryshme	33
Figura 7: Projeksionet e Popullsisë së Shqipërisë. Popullsia për disa moshë, sipas supozimeve të ndryshme	34
Figura 8: Projeksionet e Popullsisë për Rajonet e Shqipërisë, Popullsia gjithsej sipas supozimeve të ndryshme për migracionin	36
Figura 9: Projeksionet e Popullsisë për Rajonet e Shqipërisë, Piramidat e moshave në 2001 dhe 2021	38

Parashikime për popullsinë e Shqipërisë (2001-2021)

Që nga 1950 deri në 1990, popullsia e Shqipërisë ka përjetuar dekada të një rritjeje të shpejtë të popullsisë, edhe pse shpejtësia e kësaj lëvizjeje është ulur në mënyrë progresive. Lindshmëria ka qenë shumë më e lartë se në çdo vend tjetër të Evropës, edhe pse në rënie, vdekshmëria ishte relativisht e favorshme, në përputhje me modelin mesdhetar ; shkëmbimet me vendet e huaja me anë të migracionit ishin pothuaj zero dhe lëvizjet nga një rajon te tjetri në vend ishin shumë të kufizuara. Në çdo fazë të këtij procesi të butë, e ardhmja e popullsisë ishte (dhe s'kishte si të ishte ndryshe) e lehtë për t'u parashikuar nga ekstrapolimi i tendencave të vazhdueshme.

Vitet 90-të e ndryshuan në mënyrë të konsiderueshme këtë pamje. Rënia e lindshmërisë ka shkuar drejt niveleve që janë më afër standarteve evropiane, emigracioni ishte në shkallë të gjerë, dhe ka lënë gjurmë të forta në piramidën e moshës, migracioni i brendshëm e ka ndryshuar shumë ekuilibrin midis rajoneve të vendit. Kriza ekonomike dhe politike i ka theksuar shumë tendencat ekzistuese, megjithatë, është vështirë të dallohen njëra nga tjetra. E ardhmja, cilado qoftë ajo, është shumë më e pasigurtë se më parë.

Përveç këtyre vështirësive, parashikimet e popullsisë fitojnë një shkallë të lartë besueshmërie nga inercia që karakterizon shumicën e tendencave demografike. Në 2021, njëzet vjet pas regjistrimit të fundit të popullsisë, mund të vlerësohet se rreth 70% e popullsisë së vendit në atë kohë duhet të ketë qenë e pranishme dhe të jetë numëruar në 2001. Pasiguritë për këtë bërthamë të madhe të popullsisë së ardhshme do të jenë të kufizuara, dhe në veçanti, do të mund të dimë me siguri moshën e këtyre personave,

meqënëse ata do të jenë njëzet vjet më të mëdhenj në moshë që nga koha e regjistrimit.

Kjo është shumë e rëndësishme, sepse moshë është një tregues bazë për nevojat personale të cilat duhet të plotësojnë shoqëritë. Fëmijët dhe adoleshentët duhet të arsimohen nëpërmjet mësuesve dhe shkollave, të rinjtë e rritur do të kërkojnë punë në tregun e punës, shtëpi kur ata të formojnë çifte, pastaj familje, të moshuarit do të kenë nevojë për mbështetje shëndetësore nga profesionistët dhe kujdes nga të afërmit, nga shteti, apo nga kompanitë private, etj. Parashikimi i numrit të fëmijëve të rinj do të japë një tregues të vyer për theksin që i duhet vënë pajisjeve të shkollave. Parashikimet për numrin e personave aktivë që arrijnë moshën e daljes në pension do të varen nga vlerësimet e nevojave për fonde për sistemin e pensionit e të tjera.

Parashikimet e popullsisë ofrojnë një instrument bazë për planifikim social dhe ekonomik. Në faqet që vijojnë, përdoruesit do të gjejnë informacione për tendencat e mundshme të rritjes së popullsisë së Shqipërisë deri në 2021 sipas seksit, moshës dhe rajonit. Metoda që kemi zgjedhur dhe supozimet që kemi bërë përshkruhen në pjesën e parë, rezultatet kryesore paraqiten dhe analizohen në pjesën e dytë, kurse shifrat jepen në pjesën e tretë.

Popullsia e ardhme e Shqipërisë nuk përshkruhet në një parashikim të vetëm, i cili do të krijonte një ndjenjë të pavërtetë dhe të pakëndshme sigurie. Propozohen një mori tendencash, por përparësi do t'u jepet vetëm tri prej tyre. Ato tregojnë tendenca pothuaj të paevitueshme drejt rritjes demografike dhe plakjes, por shumëllojshmëria e tyre i kujton lexuesit se e ardhmja është ende e pasigurtë.

1

Metodat dhe supozimet**Metodat dhe supozimet****1.1 Metodat e parashikimit**

Numri i banorëve ndryshon çdo vit në sajë të lëvizjeve të popullsisë. Personat që vdesin dhe ata që emigrojnë janë minuse që kontribuojnë në pakësimin e popullsisë, të porsalindurit dhe të ardhurit janë pluse që e shtojnë numrin e banorëve.

Numri i vdekjeve në vit varet si nga numri i popullsisë ashtu edhe nga rreziku i vdekshmërisë. Kur ekspozohet ndaj kushteve të ngjashme shëndetësore, një popullsi me numër më të madh përjeton një numër më të madh vdekjesh, në krahasim me një popullsi më të vogël. Kushtet higjienike po ashtu luajnë një rol, vdekjet janë më të shumta, kur këto kushte janë të këqija në vend që të jenë të mira. Vetë roli i analizës demografike është të vecojë ndikimin e këtyre dy faktorëve me anë të përlogaritjes së rreziqeve të vdekshmërisë ; raportin e numrit të vdekjeve me numrin e banorëve.

Po ashtu përlogariten koeficientët e emigrimit, raporti i numrit të emigrantëve me numrin e banorëve. Nga natyra e tyre, këto raporte janë “të pavarura nga madhësia e popullsisë”. Ato mund të krahasohen nga një vend te tjetri,

Parashikimet e popullsisë nuk janë një ushtrim shkencor si gjithë të tjerët. Detyra jonë nuk është të bëjmë parashikime, por të vlerësojmë se sa do të jetë popullsia e Shqipërisë në rast se përmbushen disa supozime të caktuara. Metodat e përlogaritjes janë të thjeshta dhe të shëndosha. Analizat demografike dhe social-ekonomike janë shumë të rëndësishme për përcaktimin e supozimeve më të mundshme, por në këtë zgjidhje ka edhe një pjesë hamendjesh subjektive.

pastaj masin edhe dallimet në shfaqjen e emigracionit apo dallimet në kushtet shëndetësore.

Në rastin e lindjeve puna është disi më e komplikuar. Si mund të interpretoheshin raportet e lindjeve me popullsinë? Personat që tani mund të jenë të pranishëm mund të vdesin apo të emigrojnë vitin tjetër, dhe nuk do të lindin vitin e ardhshëm. Duke e kthyer nga ana e kundërt vështirësinë, merret në konsideratë fakti se gratë që lindin një fëmijë janë (afërsisht) po aq të shumta në numër sa edhe të porsalindurit, pastaj lidhet numri i këtyre grave me numrin e atyre që kanë të ngjarë të bëhen shtatzana (të themi gratë nga 15-50), duke përlogaritur kështu shkallën e lindshmërisë. Koeficientët e lindshmërisë janë më të lartë kur gratë mesatarisht kanë më shumë fëmijë.



Vështirësi të ngjashme hasen me të porsardhurit (imigrantët), personat që janë tani të pranishëm nuk do të jenë të porsardhur vitin e ardhshëm. Duke e pjestuar numrin e të ardhurve që hyjnë në Tiranë me numrin e njerëzve që janë tashmë në kryeqytet nuk matet diçka që të krahasohet me koeficientët e vdekshmërisë apo edhe koeficientët e lindshmërisë. Përveç këtij rasti, analiza demografike i ka ndarë veçmas vdekjet dhe emigrantët nga madhësia e popullsisë nga njëra anë dhe shkallët apo koeficientët nga ana tjetër.

Parashikimet e popullsisë i kthejnë gjërat përmbys për të llogaritur numrin e ardhshëm të lindjeve, të vdekjeve, dhe të emigrantëve nëpërmjet njohurive për madhësinë e popullsisë nga njëra anë dhe parashikimit për shkallët apo koeficientët nga ana tjetër.

Çështja e migracionit kërkon një trajtim të veçantë. Në rastin e Shqipërisë gjatë viteve të ardhshme do të përballemi me problemin e migracionit të brëndshëm, pra personat që largohen nga një vend për t'u vendosur në një vend tjetër brënda vendit. Do të bëjmë supozimin e thjeshtuar se : emigrantët nga çdo rreth quhen të ardhur (imigrantë) në rrethet e Durrësit dhe të Tiranës dhe do të përlllogarisim numrin e emigrantëve për të gjetur atë të imigrantëve në këto dy rrethe.

Përlllogaritjet bëhen çdo vit për të gjithë vendin (çdo pesë vjet për rajonet) duke filluar nga data e regjistrimit të fundit, ku njihet popullsia e prezente në shkallë vendi sipas gjinisë, moshës dhe rretheve dhe në rast se nevojitet, në bazë të një mori karakteristikash të tjera. Për lehtësi përlllogaritjeje, numri i banorëve është përlllogaritur duke filluar nga 1 janari 2001 (sipas gjinisë, moshës dhe rrethit) si pikënisje. Pastaj ka vazhduar me dy hapa të tjera:

1. Popullsia e prezente e secilës moshë (dhe gjini) plaket çdo vit më shumë dhe humbet personat që vdesin dhe emigrojnë, në raport me vdekshmërinë dhe koeficientët e emigracionit;

2. Djemtë e porsalindur dhe vajzat e këtij viti shtohen, me përjashtim të atyre që vdesin ose emigrojnë në vitin e parë të jetës përpara 1 janarit 2002. Llogaritja e tyre bëhet nga njëra anë në bazë të shkallës së lindshmërisë dhe numrit të grave në moshë riprodhuese, dhe nga ana tjetër, në bazë të vdekshmërisë foshnjore dhe emigracionit të foshnjave.

Në rrethet e Tiranës dhe të Durrësit merret parasysh edhe një faktor tjetër: shtohen edhe personat që vijnë nga rrethet e tjera. Operacioni me dy faza (tre në rastin e Durrësit dhe të Tiranës) përsëritet deri në 1 janar 2021.

Parashikimet janë bërë për të gjithë vendin dhe për të gjitha rrethet. Rrethet janë shumë (36) dhe popullsia e tyre është shumë e vogël për të bërë parashikime në këtë nivel. Kemi ngritur katër grupe rrethesh në bazë të rritjes së tyre dinamike nga 1989 deri në 2001. Jemi mbështetur tek rritja e popullsisë në periudhën midis dy regjistrimeve të fundit të popullsisë, fluksit të parashikuar të migracionit të brëndshëm (nga informacionet për ndryshimet e vendbanimit që nga regjistrimi i mëparshëm) dhe nga treguesit e shkallës së lindshmërisë (nga raportet e numrit të fëmijëve të vegjël me atë të nënave në moshë riprodhuese). Janë zgjedhur rrethe që janë afër njeri tjetrit për të përfaqësuar rajonet e Veriut, Jugut dhe Qendra e vendit. Durrësi dhe Tirana janë zgjedhur nga Qendra. Përbërja e rajoneve mund të shihet në Tabelat 1 ose 2.

Në Veri, lindshmëria është më e lartë se mesatarja dhe emigracioni i brëndshëm në shkallë të gjerë. Në pjesën tjetër të vendit, lindshmëria është pak më poshtë mesatares së vendit, pak më e ulët në Jug se sa në

Qendër, ka shpërngulje të popullsisë nga zona e Jugut, të ardhur në Durrës dhe në Tiranë dhe një ekuilibër midis hyrjeve dhe daljeve në pjesën tjetër të Qendrës. Nuk i kemi marrë parasysh emigracionin në vendet e huaja për parashikimet e rajoneve, sepse pjesa më e madhe e njohurive tona për emigracionin në vitet 90të, në sajë të regjistrimit të fundit, me siguri që nuk përshtatet me të tashmen dhe të ardhshmen.

1.2 Supozimet për nivelet dhe tendencat e ardhshme


Pika kyçe e procesit të parashikimit është prognoza për vdekshmërinë në të ardhmen dhe koeficientët e emigracionit, sikurse edhe shkalla e lindshmërisë.

Duhet të marrim parasysh vdekshmërinë sipas moshës dhe gjinisë, si edhe koeficientët e emigracionit, për të përfutur numrat e vdekjeve dhe të emigrantëve sipas moshës dhe gjinisë dhe duke zbritur nga numri fillestar i popullsisë, numrin e banorëve që janë ende të pranishëm në fund të vitit, pra, as të vdekur as në emigracion (në parashikimet e rajoneve, koeficientët sipas grupmoshave pesëvjeçare në vend të atyre një vjeçare janë të mjaftueshme).

Tradicionalisht shkalla e lindshmërisë përllogaritet për gratë. Vitet njëshe të moshës në fakt nuk nevojiten, meqënëse hollësitë për lindjet e ardhshme sipas moshës së nënave nuk janë të nevojshme, vetëm totali dhe dallimet midis djemve dhe vajzave janë instrumente të përshtatshme.

Treguesit e fundit dhe, kur është e mundur, tendencat e dekadave të fundit janë baza e parashikimit për vdekshmërinë, emigracionin, dhe lindshmërinë. Ekstrapolimi për të ardhmen udhëhiqet nga njohuritë e së kaluarës, informacioni nga vendet fqinje, ...dhe nga arsyeja.

Figura 1. Probabiliteti i vdekshmërisë sipas gjinisë dhe moshës, Shqipëria 2000-2001 & Italia 1977



1.2.1 Vdekshmëria

Koeficientët e vdekshmërisë në 2000-2001 janë llogaritur për të gjithë vendin sipas gjinisë dhe grupmoshave pesëvjeçare. Jetëgjatësia në lindje është 72.1 vjet (për meshkujt) dhe 78.6 (për femrat).

Në secilën moshë, vdekshmëria është më e lartë për meshkujt në krahasim me femrat por, shpeshtësia e moshës është e ngjashme për të dy gjinitë. Vdekshmëria ulët kur mosha rritet deri në 10-14, por më pas rritet në mënyrë të vazhdueshme. Pjesa më e madhe e risqeve të vdekshmërisë nën moshën 40 vjeç janë më pak se 1 për 1000; në moshën 8-84 janë 100 herë më të larta, rreth 1 për 10. Për një paraqitje grafike të rreziqeve që të jenë të lexueshme, është e nevojshme të përdoret një shkallë llogaritmike, e cila i rrit vlerat e vogla dhe i ul ato të lartat. Në një grafik të tillë, koeficientët në moshën mbi 45 vjeç për burrat dhe 55 për gratë janë në një vijë të drejtë, në përputhje me vëzhgimet e përgjithshme, koeficientët rriten me moshë në shkallë konstante.



Ky rezultat provon të dhënat shqiptare për moshat më të larta. Po ashtu ajo është e hapur ndaj metodës së përshtatshme për transformimin e koeficientëve pesëvjeçare në njëvjeçare, me anë të interpolimit. (Figura 1)

Krahasuar me vdekshmërinë në Itali (1997), koeficientët në çdo moshë, duke filluar nga 45, janë të ngjashme në të dy vendet. Kjo konfirmon rezultatin e evidentuar tashme nga Arjan Gjonça në tabelat e vdekshmërisë për periudhat e mëparshme. Vdekshmëria në moshat më të mëdha është po aq e favorshme në Shqipëri, sa edhe në vende të tjera mesdhetare, pavarësisht nga dallimi i madh në zhvillimin ekonomik. Një arsye madhore për këtë mund të shihet në tipin e dietës së njëjtë në këto dy vende, që duket se favorizon një jetëgjatësisë më të madhe.

Dallimet përqëndrohen në moshat më të reja, ku vdekshmëria është më e madhe në Shqipëri se në Itali. Për më tepër vlefshmëria e të dhënave në moshat më të reja është e diskutueshme. Një sondazh i kohëve të fundit në Shqipëri vë në dukje se ka 23 vdekje para moshës njëvjeçare për 1000 të porsalindur, dy herë më shumë se sa rezultatet e përfuara nga regjistrimi i lindjeve të gjalla. Të dhënat e sondazhit i kemi futur në përlogaritjet tona në vend të të dhënave "zyrtare". Kemi bërë dallim në vdekshmërinë foshnjore midis djemve dhe vajzave, po ashtu edhe në vdekjet foshnjore të regjistruara në Shqipëri nga 1997-2001; rezultoni se shkalla është 20 për 1000 vajza dhe 26 për 1000 djem.

Për fëmijët e moshave më të reja, koeficientët e vdekshmërisë janë katër herë më të larta në Shqipëri se në Itali (vdekshmëria foshnjore në Itali është 5 për 1000 vajza të porsalindura dhe 6 për 1000 djem të porsalindur, përkundrajt një vlerësimi në Shqipëri prej 20 dhe 26 respektivisht). Kur rritet moshja, hendeku relativ midis dy vendeve pakësohet dhe zhduket rreth moshës 45 vjeçare. Për shembull, vdekshmëria foshnjore do të përgjysmohet nga 2001-2005 deri në 2011-2016 (nga 23 deri në 11 për 1000) dhe përsëri nga 2011-2015 deri në 2021-2025 (nga 11 deri në 6 për 1000). Ndryshimet mbi moshën 45 vjeçare janë të kufizuara meqënëse

koeficientët e vdekshmërisë në Shqipëri dhe në Itali nuk janë shumë të ndryshme. Koeficientët e vdekshmërisë në të ardhmen (në të gjithë vendin) jepen në Tabelën 5.

Për të ardhmen, supozimi ynë i parë (VL: vdekshmëri e lartë) është se rreziqet e vdekshmërisë në Shqipëri, do të mbeten **të pandryshuara deri në 2021. Në të dytin (VU: vdekshmëri e ulët) supozojmë se hendeku i tanishëm me Italinë do të zhduket brenda dy dekadave, nga 2001-2005 në 2021-2025, kështu që në periudhën e dytë koeficientët e vdekshmërisë në Shqipërisë do të kenë arritur nivelin e tanishëm të Italisë. Dy të tretat e hendekut supozohet se do të mbushen në dekadën e parë, kurse një e treta që mbetet në dekadën e dytë.**

Vdekshmëria në rrethe nuk është dokumentuar deri tani. **Kemi marrë në shqyrtim se koeficientët në katër rajonet mund të merren si të njëjta**, pa patur pasoja të dëmshme për saktësinë e parashikimeve. Tabelat e vdekshmërisë të përdorura në parashikimet rajonale jepen në Tabelën 6; ato janë vetëm një version i shkurtuar i atyre që përdoren në nivel kombëtar.

1.2.2 Lindshmëria

Koeficientët e specifikë të lindshmërisë në bazë të moshës përmbledhen nga totalit i tyre, që tregon numrin mesatar të lindjeve të gjalla që do të kishin gratë po të jetonin të gjitha në vend, deri në fundin e moshës së tyre fertile (pra nga moshja 15 deri në 50).

Në periudhën më të fundit (2001), lindshmëria është më pak se 2.31 fëmijë për grua. Rënia ka qenë e konsiderueshme që nga 1960, ku nivelet ishin 6.85 fëmijë për grua. Rënia është bërë me shpejtësi gjatë dekadës së fundit: nga mesi i viteve 90-të deri në 2001, lindshmëria, ndonëse tashmë e moderuar, ka humbur 12%.



Gjatë kalimit nga niveli më i lartë në të ulët, lindshmëria është ulur në të gjitha moshat, më shumë kur moshë e nënave është më e madhe. Lindshmëria në moshat 40-44 është ulur me 95% nga 1960 deri në 2001; në moshat 25-29, ulja ka qenë gjysmë për gjysmë. Ky është një model klasik gjatë kësaj faze, në familjet më të mëdha ku fëmija e fundit e të cilave ka lindur në një kohë të vonë, pakësohen të parat, përpara se lëvizja të prekë familjet e mesme pastaj të voglat.

Vendet që kanë një shkallë më të lartë lindshmërie të vogël, siç është Maqedonia fqinje me 1.89 fëmijë për grua në 2001, paraqesin të njëjtat tendenca të zgjatura. Koeficientët në moshën 40-44 janë 50% nën atë të Shqipërisë, kurse ato në moshën 25-29 janë “vetëm” 10% më pak. I njëjti mekanizëm vazhdon të funksionojë. (Figura 2)

Po ta zgjerojmë përshkrimin e tendencave dhe shkallës së lindshmërisë në të gjithë Evropën, mund të shohim më qartë veçoritë e situatës shqiptare. Indeksi sintetik i lindshmërisë në 2001 (2.31 lindje për grua) është më e larta në kontinent, e vetmja bashkë me Islandën me mbi dy lindje për grua. Por Shqipëria është edhe vendi me rënien më të shpejtë të lindshmërisë në dekadat e fundit, bashkë me një numër të vogël vendesh që posa kanë fituar pavarësinë si Kaukazi dhe Azerbajxhani. Duke pasur parasysh nivelin ende të lartë të lindshmërisë në vend dhe ritmin e rënies së vazhdueshme, nuk ka pothuaj asnjë dyshim se lindshmëria në Shqipëri do të vazhdojë të bjerë në dekadat e ardhshme. Çështje ende e hapur është ajo që lidhet me thellësinë dhe shpejtësinë e rënies në vitet e ardhshme.

Ulja e lindshmërisë në Evropën Qendrore që nga vitet 60-të është shoqëruar me transformime të mëdha në formimin e familjes (martesa në moshë më të madhe, më shumë divorce, krijimi i bashkimeve jozyrtare). Ky proces kompleks është reflektuar edhe në ndryshime vlerash (individualizmi, laicizimi, arsimim në rritje), të cilat përfshijnë ndryshime në rolet e gjinive. Në Evropën Lindore, pas rënies së komunizmit, lindshmëria është

Figura 2. Koeficientet specifike të lindshmërisë



pakësuar në mënyrë dramatike, një fenomen të cilin disa studiues e shpjegojnë me mekanizma të ngjashme dhe të tjerë me vështirësitë financiare që kalojnë ato gjatë tranzicionit në ekonomitë e tregut.

Në kryqëzimin e dy lëvizjeve, Shqipëria dhe Ballkani rrethohen nga disa vende me lindshmërinë më të ulët, si Italia në Perëndim, ose Bullgaria në Lindje, me më pak se 1.3 lindje për grua.



Tabela 1. Tregues të Lindshmërisë sipas rretheve dhe rajoneve

Vendi, rrethet, rajonet	Regjistrimi 2001			Indeksi sintetik i lindshmërisë 1995-2001
	Fëmije 0-4	Gra 20-49	Raporti Fëmije-Grua	
	(Numër)	(Numër)	(Përqind)	Fëmije lindur gjallë për grua
SHQIPERIA	269809	643929	41,90	2,47
Bulqizë	4773	8444	56,53	3,33
Dibër	9521	16574	57,45	3,39
Has	2464	3681	66,94	3,95
Kukës	7755	12233	63,39	3,74
Mat	6124	12564	48,74	2,87
Mirditë	3485	7702	45,25	2,67
Pukë	3655	6705	54,51	3,21
Tropojë	2873	5667	50,70	2,99
Rajoni Verior	40650	73570	55,25	3,26
Durrës	15194	39328	38,63	2,28
Elbasan	20455	46927	43,59	2,57
Gramsh	3282	7158	45,85	2,70
Kavajë	6928	17379	39,86	2,35
Krujë	6406	13285	48,22	2,84
Kurbin	5490	11663	47,07	2,77
Lezhë	5843	14381	40,63	2,40
Librazhd	7143	14127	50,56	2,98
Lushnje	12010	30794	39,00	2,30
Malesi e Madhe	3482	7403	47,03	2,77
Peqin	3304	6869	48,10	2,84
Shkodër	16446	38724	42,47	2,50
Tiranë	42546	113828	37,38	2,20
Rajoni Qendror	148529	361866	41,05	2,42
Berat	10851	27013	40,17	2,37
Delvinë	721	1921	37,53	2,21
Devoll	2724	7099	38,37	2,26
Fier	16725	42349	39,49	2,33
Gjirokastrë	4017	11269	35,65	2,10
Kolonjë	1154	3547	32,53	1,92
Korçë	10443	29755	35,10	2,07
Kuçovë	2926	7817	37,43	2,21
Mallakastër	3675	8042	45,70	2,69
Përmet	1722	5210	33,05	1,95
Pogradec	6253	14536	43,02	2,54
Sarandë	2654	6821	38,91	2,29
Skrapar	2204	6253	35,25	2,08
Tepelenë	2535	6397	39,63	2,34
Vlorë	12026	30464	39,48	2,33
Rajoni Jugor	80630	208493	38,67	2,28

Indeksi sintetik i lindshmërisë i llogaritur për vendin në 1995-2001 është shpërndarë sipas rretheve dhe rajoneve në proporcion me raportin fëmijë-grua në 2001.

Pasiguria e tendencave të lindshmërisë në të ardhmen është e madhe, duke patur parasysh nivelin ende të lartë të lindshmërisë në Shqipëri sipas standarteve europiane, dhe shpërndarja e forcave të punës në rajon, të cilat e çojnë lindshmërinë në nivele shumë të ulta. **Në parashikimet për të gjithë vendin, supozojmë se lindshmëria do të vazhdojë të bjerë në mënyrë lineare në dy dekadat e ardhshme drejt mesatareve deri në 1.8 apo drejt niveleve të ulta prej deri në 1.4 fëmijë të lindur të gjallë për grua në 2021.** Koeficientët janë shpërndarë sipas moshës së nënave si në vitin 2001. Për lehtësi llogaritjeje, vitet njëshe të moshës janë përdorur në parashikimet kombëtare, kurbat e koeficienteve specifike të moshës prej pesë vjetësh në 2001 janë zbutur me qëllim. Vlerësimet që dalin për lindshmërinë që do të përdoren në parashikimet kombëtare jepen në (Tabelat 7 dhe 8).

Lindshmëria ndryshon sipas rajoneve. Regjistrimi i fundit na jep një bazë të mirë për vlerësimin e lindshmërisë sipas rrethit në pesë vitet e mëparshme. Mesatarja për të gjithë vendin ishte 2.47 fëmijë për grua dhe rezultatet në Qendër të vendit (duke përfshirë Tiranën dhe Durrësin) nuk ndryshonin shumë (2.42). Lindshmëria ishte shumë më e lartë në Veri (3.26) dhe më e ulët në Jug (2.28) (Tabela 1). **Ne supozojmë se lindshmëria kombëtare do të ketë tendencë të jetë 1.8 lindje për grua dhe se nivelet relative në tri grupet nuk do të ndryshojnë, duke rënë propozionalisht në mbarë vendin.** Lindshmëria në të ardhmen për rajonet jepet në (Tabelën 9).

1.2.3 Migracioni

Në vitet 90-të, Shqipëria kaloi dy fenomene krejtësisht të reja: emigracion masiv në vende të huaja dhe një migracion të madh të brendshëm nga njëri rreth në tjetrin. Të dy këto fenomene u dokumentuan në të dhënat e regjistrimit të popullsisë, edhe pse vetëm indirekt për të parin, gjë që rezultoi për personat që mungonin dhe nuk u numëruan.

Në këtë rast, duhet të bëhet një vlerësim për personat që do të ishin numëruar në Shqipëri po të mos kishte ndodhur emigracioni jashtë vendit (pra, në rast se popullsia e vendit do të ndikohej vetëm nga vdekshmëria dhe lindshmëria). Kjo popullsi hipotetike do të krahasohej me atë aktuale me qëllim që të llogaritej emigracioni. Vlerësimi është global dhe mbulon të gjithë periudhën e llogaritjes: në Shqipëri mbulohen vitet 1989-2001 nga njëri vit i regjistrimit tek tjetri.

Eshtë shumë më e thjeshtë në rastin e migracionit të brendshëm, meqënëse personat që janë larguar nga një rreth në një tjetër mund të identifikohen, të gjendet ku janë vendosur dhe të numërohen. Në Shqipëri janë bërë këto dy llogaritje për ata që kanë lëvizur pas regjistrimit të mëparshëm (1989-2001) dhe ata që kanë migruar gjatë vitit përpara regjistrimit (2000-2001)

Emigracioni është vlerësuar me një shifër prej 0.6 milionësh gjatë dymbëdhjetë vjetëve, pra rreth 50,000 në vit, por me ndryshime të rëndësishme nga viti në vit. Pas një piku në fund të viteve 90-të, emigracioni thuhet se ka rënë, por dihet pak ose aspak për nivelin e tij të tanishëm. **Për qëllimin e parashikimeve, bëjmë dy supozime: në të ardhmen, emigracioni jashtë vendit do të jetë ose zero ose rreth 15,000 emigrantë në vit.** Për lehtësi llogaritjeje, e riformulojmë këtë të fundit: 0.5 përqind e popullsisë do të emigrojë çdo vit, pra rreth 15,000 emigrantë, ku numri i banorëve është rreth 3 milionë, si në vitin 2001, pak më shumë ose pak më pak, në varësi të tendencave të ardhshme të popullsisë.

Piramida e vlerësuar e moshës të atyre që emigrojnë jashtë vendit në 1989-2001 ka pak rëndësi, përse i përket shpërndarjes të lëvizjeve të ardhshme, sipas moshës dhe gjinisë. Preferojmë të mbështetemi më shumë në informacione të sakta në lidhje me veçoritë e migrantëve të brendshëm në vitin para regjistrimit të fundit, duke supozuar kështu se piramidat e moshës nuk janë të

Tabela 2. Migracioni i brendshëm sipas rretheve dhe rajoneve. Meshkuj

Rrethet, Rajonet	Migracioni 2000-2001			Migracioni 1989-2001		
	Popullsia 2000*	Migracioni Neto	Risku (%) / pop. 2000	Popullsia 1989*	Migracioni Neto	Risku (%) / pop. 1989
Bulqizë	21598	-477	-2,31	17433	-2297	-13,18
Dibër	43789	-1149	-2,77	45844	-15125	-32,99
Has	10051	-340	-3,63	8133	-1650	-20,29
Kukës	31591	-398	-1,29	35262	-13186	-37,39
Mat	29960	-200	-0,68	28745	-6446	-22,42
Mirditë	18470	-449	-2,56	18833	-5280	-28,04
Pukë	17824	-518	-3,09	19565	-6984	-35,70
Tropojë	14051	-222	-1,63	16622	-6547	-39,39
Gjithsej Veriu	187334	-3753	-2,09	190437	-57515	-30,20
Durrës	81074	2255	2,63	48367	18827	38,93
Elbasan	108312	34	0,03	84471	165	0,20
Gramsh	18751	-542	-3,07	18201	-4591	-25,22
Kavajë	35221	-30	-0,09	26071	-71	-0,27
Krujë	30768	15	0,05	23148	129	0,56
Kurbin	25535	135	0,52	17805	1761	9,89
Lezhë	31832	91	0,28	21842	2852	13,06
Librazhd	36811	-462	-1,29	31704	-4356	-13,74
Lushnje	69186	415	0,59	52768	2475	4,69
Malesi e Madhe	18225	-498	-2,89	13818	-739	-5,35
Peqin	16549	-296	-1,85	12967	-915	-7,06
Shkodër	88310	221	0,25	69020	11	0,02
Tiranë	239767	6040	2,40	137406	64739	47,12
Gjithsej Qendra	800341	7378	0,91	557588	80287	14,40
Durres/Tirana	320841	8295	2,46	185773	83566	44,98
Qendra pa Tir/Dur	479500	-917	-0,19	371815	-3279	-0,88
Berat	66944	-2257	-3,62	55867	-5969	-10,68
Delvinë	5393	-75	-1,43	4553	-81	-1,78
Devoll	17105	-137	-0,81	14762	-820	-5,55
Fier	96689	-226	-0,23	76901	-1277	-1,66
Gjirrokastër	26067	273	1,03	21542	215	1,00
Kolonjë	9059	-299	-3,53	9062	-2058	-22,71
Korçë	70147	-189	-0,27	62397	-4772	-7,65
Kuçovë	17139	-37	-0,22	13021	566	4,35
Mallakastër	19201	214	1,09	13890	1563	11,25
Përmet	13251	-287	-2,26	13469	-3045	-22,61
Pogradec	34866	-12	-0,03	29174	-1590	-5,45
Sarandë	17009	111	0,64	12672	1509	11,91
Skrapar	15174	-244	-1,66	17198	-5240	-30,47
Tepelenë	17276	-658	-4,12	16919	-4257	-25,16
Vlorë	69338	198	0,28	53351	2484	4,66
Gjithsej Juq	494658	-3625	-0,74	414778	-22772	-5,49

*) Popullsia e regjistruar në 2001 sipas vendbanimit 12 muaj dhe 12 vjet më parë



Tabela 3. Migracioni i brendshëm sipas rretheve dhe rajoneve. Femra

Rrethet, Rajonet	Migracioni 2000-2001			Migracioni 1989-2001		
	Popullsia 2000	Migracioni Neto	Risku (%)/ pop. 2000	Popullsia 1989	Migracioni Neto	Risku (%)/ pop. 1989
Bulqizë	21843	-438	-2,09	17498	-1891	-10,81
Dibër	43291	-1247	-3,06	45557	-15014	-32,96
Has	10397	-362	-3,74	8427	-1518	-18,01
Kukës	31375	-379	-1,24	35221	-12820	-36,40
Mat	30303	-223	-0,75	29587	-6629	-22,41
Mirditë	19365	-441	-2,39	19822	-5423	-27,36
Pukë	17662	-535	-3,22	19203	-6633	-34,54
Tropojë	14005	-209	-1,54	16876	-6418	-38,03
Gjithsej Veriu	188241	-3834	-2,12	192191	-56346	-29,32
Durrës	86193	2220	2,45	54198	18771	34,63
Elbasan	106571	-9	-0,01	84413	-439	-0,52
Gramsh	18120	-517	-3,03	17448	-4340	-24,87
Kavajë	41489	-122	-0,30	32982	-523	-1,59
Krujë	30858	35	0,11	23918	-156	-0,65
Kurbini	26445	156	0,58	18545	2121	11,44
Lezhë	33538	91	0,27	23838	2721	11,41
Librazhd	35314	-399	-1,16	31043	-4713	-15,18
Lushnje	69071	299	0,43	53304	2234	4,19
Malesi e Madhe	19441	-504	-2,73	15127	-761	-5,03
Peqin	16676	-309	-1,92	12902	-689	-5,34
Shkodër	91178	216	0,24	73376	-487	-0,66
Tiranë	240095	6144	2,43	140161	66080	47,15
Gjithsej Qendra	814989	7301	0,88	581255	79819	13,73
Durrës/Tirana	326288	8364	2,44	194359	84851	43,66
Qendra pa Tir/Dur	488701	-1063	-0,22	386896	-5032	-1,30
Berat	65287	-2054	-3,36	55061	-6273	-11,39
Delvinë	5249	-80	-1,57	4420	-119	-2,69
Devoll	16854	-106	-0,64	14231	-366	-2,57
Fier	98499	-363	-0,37	79702	-1614	-2,03
Gjirokastrë	26025	216	0,82	21519	283	1,32
Kolonjë	8830	-281	-3,40	8713	-1888	-21,67
Korçë	69570	-100	-0,14	62152	-4516	-7,27
Kuçovë	17306	13	0,08	13202	836	6,33
Mallakastër	18323	192	1,03	13382	1426	10,66
Përmet	13065	-293	-2,35	13370	-3073	-22,98
Pogradec	33857	-37	-0,11	28299	-1585	-5,60
Sarandë	16563	103	0,61	12556	1293	10,30
Skopë	14971	-279	-1,94	17004	-5336	-31,38
Tepelenë	16898	-623	-3,98	17126	-4535	-26,48
Vlorë	72202	225	0,31	56856	1994	3,51
Gjithsej Juhu	493499	-3467	-0,71	417593	-23473	-5,62

*) Popullsia e regjistruar në 2001 sipas vendbanimit 12 muaj dhe 12 vjet më parë

ndryshme për emigrantët e jashtëm dhe të brendshëm, që ndodh shpesh. Do të japim më shumë hollësi në paragrafët që vijojnë.

Gjatë vitit para regjistrimit të fundit, rajoni i Veriut kish humbur 2.1 % të banorëve të tij, të cilët ishin vendosur diku gjetkë në Shqipëri. Kjo ishte tri herë më e vogël në Jug (0.7%) dhe pothuaj e papërfillshme në Qendër (0.2%, pa Tiranën dhe Durrësin). Përkundrazi, rrethet e Tiranës dhe të Durrësit kishin përfituar më shumë se 16,000 banorë. (Tabelat 2 dhe 3)

Gjatë dymbëdhjetë vjetëve midis dy regjistrimeve, lëvizjet e përgjithshme ishin natyrisht më intensive, për shkak të gjatësisë së periudhës, por renditja e rajoneve ishte e njëjtë: humbje të mëdha në Veri, të moderuara në Jug dhe shumë të kufizuara në Qendër; shtim të madh në Tiranë dhe në Durrës. Orientimi i lëvizjeve ishte shumë i stabilizuar.

Për të ardhmen, supozojmë se mundësia e largimit nga secili prej tri rajoneve do të mbetet në nivelin e tyre më të fundit (2000-2001). Humbjet në tri rajonet do të rezultojnë të barabarta me ato të fituara nga Tirana dhe nga Durrësi.

Largimet nga tri rajonet në 2000-2001 ishin shumë të balancuara midis meshkujve dhe femrave. Ajo që është për t'u çuditur është se probabilitetet e largimit ishin pothuaj të barabarta për të gjitha moshat, të paktën deri në moshën 60 vjeçare, dhe ishin pak më pak në moshat më të vjetra. Migracioni ishte në bazë familje, me largime jo të individëve, por të grupeve më të mëdha; prindërit me fëmijë dhe me prindërit e tyre. (Tabela 4)

Meqënëse thjeshtësia dhe realiteti përputhen, supozojmë se probabilitetet e emigracionit të brendshëm të matura në 2000-2001 në secilin rajon (2.1% në Veri, 0.7 % në Jug dhe 0.2 % në Qendër) janë njëlloj të vlefshëm për meshkujt dhe femrat dhe për secilën moshë.

Tabela 4. Koeficientet e emigracionit sipas rajoneve dhe grup-moshave 2000-2001

Rajonet	Grup-moshat			
	0-14 vjeç	15-39 vjeç	40-59 vjeç	60+ vjeç
Veri	2.23%	2.06%	2.04%	1.50%
Qendër*	0.16%	0.21%	0.26%	0.20%
Jug	0.75%	0.74%	0.75%	0.57%

^{*)} Rrethet Tirana dhe Durrësi nuk përfshihen

Supozimi përfshin edhe emigracionin në vende të huaja: kur emigron 0.5% e totalit të popullsisë, kjo mund të vlejë për meshkujt dhe femrat dhe për secilën moshë. (Tabela 10)

Migracion i brendshëm ndikon vetëm në ekuilibrin rajonal të popullsisë së Shqipërisë; nuk ka ndonjë ndikim në popullsinë e përgjithshme të vendit dhe nuk përfshihet në parashikimet e popullsisë për të gjithë vendin. Por e kundërta nuk mund të thuhet për emigracionin jashtë vendit, i cili prek popullsinë e përgjithshme dhe që mund të ketë ndikim të ndryshëm në rajone të ndryshme. Në vitet nëntëdhjetë, emigracioni masiv në vende të huaja e preku më shumë Jugun se Veriun.

Nuk kemi një informacion të tillë për lëvizjet e tanishme, të cilat mund të shtohen në të ardhmen. **Rrjedhimisht, parashikimet e rajoneve kombinojnë me supozimin për migracionin e brendshëm të ruajtur në nivelin e 2000-2001 dhe pa ndonjë emigracion të jashtëm. Supozimi për rreth 15,000 emigrantë që ikin jashtë vendit nuk merret në konsideratë në nivel rajoni.**

1.3 Seria e parashikimeve të popullsisë

Në nivel kombëtar, ka dy supozime për vdekshmërinë (niveli i vdekshmërisë mbetet i pandryshuar në vitin 2000-2001, ose ulet me ngadalë drejt shifrave më të favorshme); ato

kombinohen me dy supozime për lindshmërinë (lindshmëria ulet deri në 1.8 ose 1.4 lindje të gjalla për grua) dhe dy supozime për emigracionin jashtë vendit (emigrantët çdo vit janë zero ose 0.5 përqind të popullsisë).

Kjo rezulton në tetë grupe parashikimesh, të cilat kombinojnë vdekshmërinë konstante (1) ose vdekshmërinë në rënie (2) me:

- Lindshmërinë relativisht të ulët (1.4 fëmijë) dhe me mungesën e emigracionit;
- Lindshmërinë relativisht të ulët dhe 0.5% emigracion;
- Lindshmërinë relativisht të lartë (1.8 fëmijë) dhe me mungesën e emigracionit;
- Lindshmërinë relativisht të lartë dhe 0.5% emigracion.

Në nivel rajoni, supozimi i vdekshmërisë është unik dhe i njëjtë për rajone të ndryshme (koeficientët e vdekshmërisë janë konstantë në nivelin e tyre të 2000-2001 dhe të ngjashëm me ato të parashikimeve kombëtare). Ka vetëm një supozim për lindshmërinë ku koeficienti bie deri në 1.8 lindje për grua, por aty futen dallimet sipas rajoneve. Ka vetëm një supozim për migracionin që kombinon mungesën e emigracionit jashtë dhe migracionin e brendshëm duke riprodhuar modelet e 2000-2001. Kjo rezulton në një grup të vetëm parashikimesh.

Parashikimet kombëtare japën për çdo vit, sipas gjinisë dhe moshës (një vjeçare). Për parashikimet rajonale, rezultatet nxirren çdo pesë vjet, popullsia klasifikohet sipas gjinisë dhe grupmoshave pesëvjeçare.



1.4 Konkluzione

Parashikimet e popullsisë janë rezultat i një procedure më shumë të tipit mekanik, që është dhënë shkurtimisht në faqet e para të kësaj pjese dhe të cilën e kemi futur në format Excel për të mundësuar manipulimet gjysmë automatike nga njerëzit që përgjigjen për menazhimin e tyre.

Çështja kyç është përzgjedhja e supozimeve, në bazë të analizës së tendencave të shkuara të vdekshmërisë, lindshmërisë dhe migracionit dhe ecurinë e tyre në të ardhmen. Kemi përmbledhur këtu zgjedhjet që kemi bërë për parashikimet kombëtare dhe rajonale.

E kemi mënjanuar përdorimin e një hipoteze të vetme, e cila mund të interpretohet si një siguri për të ardhmen. Supozime të tjera mund të parashikohen në rast se disa përdorues e duan një gjë të tillë.

Në rast të një informacioni i ri për vdekshmërinë, lindshmërinë apo tendencat e migracionit mund të rishikohen përlllogaritjet gjatë periudhës së parashikimit. Elasticiteti i mënyrës që kemi zgjedhur e bën atë mjaft të përdorueshme.

Tabela 5. Koeficientet specifike të mortalitetit të moshës 0 deri 44, Projektionet e Shqipërisë sipas periudhave

Moshë	2001-2005		2006-2010		2011-2015		2016-2020	
	Meshkuj	Femra	Meshkuj	Femra	Meshkuj	Femra	Meshkuj	Femra
0	0,02600	0,02000	0,01948	0,01514	0,01297	0,01028	0,00961	0,00777
1	0,00177	0,00162	0,00132	0,00123	0,00087	0,00084	0,00063	0,00064
2	0,00142	0,00122	0,00106	0,00093	0,00069	0,00063	0,00051	0,00048
3	0,00115	0,00092	0,00086	0,00070	0,00056	0,00048	0,00041	0,00036
4	0,00097	0,00074	0,00073	0,00056	0,00048	0,00038	0,00035	0,00029
5	0,00063	0,00040	0,00049	0,00033	0,00035	0,00025	0,00027	0,00021
6	0,00057	0,00038	0,00044	0,00031	0,00031	0,00023	0,00025	0,00020
7	0,00054	0,00033	0,00041	0,00027	0,00029	0,00020	0,00023	0,00017
8	0,00047	0,00031	0,00037	0,00025	0,00026	0,00019	0,00020	0,00016
9	0,00050	0,00026	0,00039	0,00021	0,00028	0,00016	0,00022	0,00014
10	0,00031	0,00015	0,00026	0,00014	0,00021	0,00012	0,00018	0,00012
11	0,00035	0,00017	0,00029	0,00015	0,00023	0,00014	0,00020	0,00013
12	0,00044	0,00020	0,00036	0,00018	0,00029	0,00016	0,00025	0,00015
13	0,00054	0,00022	0,00045	0,00020	0,00036	0,00018	0,00031	0,00017
14	0,00073	0,00025	0,00060	0,00023	0,00048	0,00020	0,00041	0,00019
15	0,00052	0,00027	0,00050	0,00025	0,00048	0,00022	0,00047	0,00021
16	0,00069	0,00030	0,00067	0,00027	0,00065	0,00025	0,00063	0,00023
17	0,00085	0,00034	0,00082	0,00031	0,00079	0,00028	0,00078	0,00027
18	0,00097	0,00038	0,00094	0,00035	0,00091	0,00031	0,00089	0,00030
19	0,00106	0,00041	0,00103	0,00037	0,00099	0,00034	0,00097	0,00032
20	0,00129	0,00057	0,00119	0,00049	0,00109	0,00040	0,00104	0,00035
21	0,00129	0,00056	0,00119	0,00047	0,00109	0,00039	0,00104	0,00034
22	0,00133	0,00054	0,00123	0,00046	0,00113	0,00037	0,00107	0,00033
23	0,00133	0,00054	0,00123	0,00046	0,00113	0,00037	0,00107	0,00033
24	0,00130	0,00054	0,00120	0,00046	0,00110	0,00037	0,00105	0,00033
25	0,00158	0,00051	0,00139	0,00044	0,00120	0,00038	0,00110	0,00034
26	0,00160	0,00055	0,00140	0,00048	0,00121	0,00041	0,00111	0,00038
27	0,00160	0,00060	0,00140	0,00053	0,00121	0,00045	0,00111	0,00041
28	0,00174	0,00070	0,00153	0,00061	0,00132	0,00052	0,00121	0,00048
29	0,00187	0,00077	0,00164	0,00067	0,00141	0,00057	0,00130	0,00052
30	0,00152	0,00062	0,00144	0,00058	0,00136	0,00055	0,00132	0,00054
31	0,00160	0,00065	0,00152	0,00062	0,00144	0,00058	0,00139	0,00057
32	0,00170	0,00068	0,00161	0,00064	0,00152	0,00061	0,00148	0,00059
33	0,00175	0,00070	0,00166	0,00066	0,00157	0,00063	0,00153	0,00061
34	0,00181	0,00072	0,00172	0,00069	0,00163	0,00065	0,00158	0,00063
35	0,00177	0,00071	0,00169	0,00068	0,00162	0,00066	0,00159	0,00064
36	0,00178	0,00076	0,00171	0,00074	0,00163	0,00071	0,00160	0,00069
37	0,00177	0,00078	0,00169	0,00076	0,00162	0,00073	0,00159	0,00071
38	0,00180	0,00082	0,00173	0,00079	0,00165	0,00076	0,00162	0,00074
39	0,00186	0,00087	0,00178	0,00084	0,00171	0,00081	0,00167	0,00080
40	0,00179	0,00104	0,00175	0,00097	0,00171	0,00091	0,00169	0,00087
41	0,00184	0,00110	0,00180	0,00103	0,00176	0,00096	0,00174	0,00093
42	0,00196	0,00124	0,00192	0,00116	0,00187	0,00108	0,00185	0,00104
43	0,00213	0,00137	0,00208	0,00129	0,00204	0,00120	0,00201	0,00115
44	0,00239	0,00153	0,00234	0,00144	0,00228	0,00134	0,00226	0,00129



vazhdon... **Tabela 5.** Koeficientet specifike të mortalitetit të moshës 45 deri 89,
Projeksionet e Shqipërisë sipas periudhave

Moshë	2001-2005		2006-2010		2011-2015		2016-2020	
	Meshkuj	Femra	Meshkuj	Femra	Meshkuj	Femra	Meshkuj	Femra
45	0,00243	0,00169	0,00243	0,00169	0,00243	0,00169	0,00243	0,00169
46	0,00270	0,00169	0,00270	0,00169	0,00270	0,00169	0,00270	0,00169
47	0,00300	0,00169	0,00300	0,00169	0,00300	0,00169	0,00300	0,00169
48	0,00333	0,00169	0,00333	0,00169	0,00333	0,00169	0,00333	0,00169
49	0,00370	0,00169	0,00370	0,00169	0,00370	0,00169	0,00370	0,00169
50	0,00411	0,00253	0,00411	0,00253	0,00411	0,00253	0,00411	0,00253
51	0,00456	0,00253	0,00456	0,00253	0,00456	0,00253	0,00456	0,00253
52	0,00507	0,00253	0,00507	0,00253	0,00507	0,00253	0,00507	0,00253
53	0,00562	0,00253	0,00562	0,00253	0,00562	0,00253	0,00562	0,00253
54	0,00625	0,00253	0,00625	0,00253	0,00625	0,00253	0,00625	0,00253
55	0,00693	0,00237	0,00693	0,00237	0,00693	0,00237	0,00693	0,00237
56	0,00770	0,00269	0,00770	0,00269	0,00770	0,00269	0,00770	0,00269
57	0,00855	0,00307	0,00855	0,00307	0,00855	0,00307	0,00855	0,00307
58	0,00949	0,00349	0,00949	0,00349	0,00949	0,00349	0,00949	0,00349
59	0,01053	0,00398	0,01053	0,00398	0,01053	0,00398	0,01053	0,00398
60	0,01169	0,00453	0,01169	0,00453	0,01169	0,00453	0,01169	0,00453
61	0,01298	0,00516	0,01298	0,00516	0,01298	0,00516	0,01298	0,00516
62	0,01441	0,00587	0,01441	0,00587	0,01441	0,00587	0,01441	0,00587
63	0,01599	0,00669	0,01599	0,00669	0,01599	0,00669	0,01599	0,00669
64	0,01774	0,00762	0,01774	0,00762	0,01774	0,00762	0,01774	0,00762
65	0,01969	0,00867	0,01969	0,00867	0,01969	0,00867	0,01969	0,00867
66	0,02184	0,00987	0,02184	0,00987	0,02184	0,00987	0,02184	0,00987
67	0,02423	0,01124	0,02423	0,01124	0,02423	0,01124	0,02423	0,01124
68	0,02688	0,01280	0,02688	0,01280	0,02688	0,01280	0,02688	0,01280
69	0,02981	0,01456	0,02981	0,01456	0,02981	0,01456	0,02981	0,01456
70	0,03306	0,01657	0,03306	0,01657	0,03306	0,01657	0,03306	0,01657
71	0,03665	0,01886	0,03665	0,01886	0,03665	0,01886	0,03665	0,01886
72	0,04062	0,02146	0,04062	0,02146	0,04062	0,02146	0,04062	0,02146
73	0,04502	0,02441	0,04502	0,02441	0,04502	0,02441	0,04502	0,02441
74	0,04988	0,02776	0,04988	0,02776	0,04988	0,02776	0,04988	0,02776
75	0,05525	0,03156	0,05525	0,03156	0,05525	0,03156	0,05525	0,03156
76	0,06118	0,03588	0,06118	0,03588	0,06118	0,03588	0,06118	0,03588
77	0,06772	0,04077	0,06772	0,04077	0,06772	0,04077	0,06772	0,04077
78	0,07494	0,04631	0,07494	0,04631	0,07494	0,04631	0,07494	0,04631
79	0,08289	0,05259	0,08289	0,05259	0,08289	0,05259	0,08289	0,05259
80	0,09165	0,05969	0,09165	0,05969	0,09165	0,05969	0,09165	0,05969
81	0,10128	0,06772	0,10128	0,06772	0,10128	0,06772	0,10128	0,06772
82	0,11187	0,07678	0,11187	0,07678	0,11187	0,07678	0,11187	0,07678
83	0,12348	0,08701	0,12348	0,08701	0,12348	0,08701	0,12348	0,08701
84	0,13622	0,09852	0,13622	0,09852	0,13622	0,09852	0,13622	0,09852
85	0,15017	0,11147	0,15017	0,11147	0,15017	0,11147	0,15017	0,11147
86	0,16542	0,12601	0,16542	0,12601	0,16542	0,12601	0,16542	0,12601
87	0,18207	0,14231	0,18207	0,14231	0,18207	0,14231	0,18207	0,14231
88	0,20021	0,16053	0,20021	0,16053	0,20021	0,16053	0,20021	0,16053
89	0,21993	0,18085	0,21993	0,18085	0,21993	0,18085	0,21993	0,18085

Tabela 6. Të mbijetuarit në tabelat e vdekshmërisë. Projektionet e Shqipërisë, sipas periudhave

Moshë	2001-2005		2006-2010		2011-2015		2016-2020	
	Meshkuj	Femra	Meshkuj	Femra	Meshkuj	Femra	Meshkuj	Femra
0	10000	10000	10000	10000	10000	10000	10000	10000
1	9740	9800	9805	9849	9870	9897	9904	9922
5	9688	9756	9766	9815	9845	9874	9885	9905
10	9662	9740	9746	9802	9830	9864	9874	9896
15	9639	9730	9727	9793	9815	9856	9860	9888
20	9600	9713	9688	9778	9777	9842	9823	9875
25	9537	9687	9630	9755	9723	9823	9772	9859
30	9457	9657	9559	9728	9662	9800	9715	9838
35	9378	9624	9483	9697	9589	9771	9644	9809
40	9294	9586	9402	9661	9511	9735	9567	9774
45	9201	9526	9310	9604	9419	9682	9476	9722
50	9062	9446	9169	9523	9277	9600	9333	9640
55	8833	9327	8937	9403	9042	9479	9096	9519
60	8457	9182	8557	9257	8658	9332	8710	9371
65	7859	8911	7951	8984	8045	9057	8094	9095
70	6942	8414	7024	8482	7107	8551	7150	8587
75	5629	7535	5696	7596	5763	7658	5798	7690
80	3949	6097	3996	6147	4043	6197	4067	6223
85	2168	4062	2193	4095	2219	4128	2233	4145
90	785	1860	794	1875	803	1891	808	1898
95	139	412	141	415	142	419	143	421
e_0	72.1	78.6	72.9	79.2	73.6	79.8	74	80.1

¹⁾ Jetëgjatësia (në vite dhe dhjetëvjeçare)



Tabela 7. Koefficientët specifikë të lindshmërisë. Projektionet, Shqipëria për vitet (2001-2010).

Lindshmëri e lartë

Mosha	2001	2002	2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010
15	0,001	0,001	0,001	0,001	0,001	0,001	0,001	0,001	0,001	0,001
16	0,003	0,003	0,003	0,003	0,003	0,003	0,003	0,003	0,003	0,003
17	0,013	0,013	0,013	0,013	0,012	0,012	0,012	0,012	0,012	0,012
18	0,024	0,024	0,023	0,023	0,023	0,022	0,022	0,022	0,022	0,021
19	0,050	0,049	0,048	0,047	0,046	0,046	0,045	0,044	0,044	0,044
20	0,083	0,081	0,080	0,078	0,077	0,076	0,075	0,074	0,073	0,073
21	0,111	0,108	0,106	0,105	0,103	0,102	0,100	0,099	0,098	0,097
22	0,139	0,136	0,133	0,131	0,129	0,127	0,125	0,123	0,122	0,121
23	0,161	0,157	0,154	0,152	0,150	0,147	0,145	0,143	0,142	0,140
24	0,178	0,173	0,170	0,167	0,165	0,163	0,160	0,158	0,157	0,155
25	0,187	0,182	0,178	0,176	0,173	0,171	0,168	0,166	0,164	0,163
26	0,180	0,176	0,172	0,169	0,167	0,165	0,162	0,160	0,158	0,157
27	0,170	0,166	0,162	0,160	0,158	0,156	0,153	0,151	0,150	0,148
28	0,156	0,152	0,148	0,146	0,144	0,142	0,140	0,138	0,137	0,136
29	0,141	0,138	0,135	0,133	0,131	0,129	0,127	0,125	0,124	0,123
30	0,128	0,125	0,122	0,120	0,119	0,117	0,115	0,114	0,113	0,111
31	0,117	0,114	0,111	0,110	0,108	0,107	0,105	0,104	0,103	0,102
32	0,100	0,098	0,095	0,094	0,093	0,092	0,090	0,089	0,088	0,087
33	0,083	0,081	0,080	0,078	0,077	0,076	0,075	0,074	0,073	0,073
34	0,067	0,065	0,064	0,063	0,062	0,061	0,060	0,059	0,059	0,058
35	0,053	0,052	0,051	0,050	0,050	0,049	0,048	0,047	0,047	0,046
36	0,042	0,041	0,040	0,040	0,039	0,039	0,038	0,038	0,037	0,037
37	0,033	0,033	0,032	0,031	0,031	0,031	0,030	0,030	0,029	0,029
38	0,026	0,025	0,024	0,024	0,024	0,023	0,023	0,023	0,023	0,022
39	0,018	0,017	0,017	0,017	0,017	0,016	0,016	0,016	0,016	0,015
40	0,013	0,013	0,013	0,013	0,012	0,012	0,012	0,012	0,012	0,012
41	0,009	0,009	0,008	0,008	0,008	0,008	0,008	0,008	0,008	0,008
42	0,007	0,007	0,006	0,006	0,006	0,006	0,006	0,006	0,006	0,006
43	0,004	0,004	0,004	0,004	0,004	0,004	0,004	0,004	0,004	0,004
44	0,003	0,003	0,003	0,003	0,003	0,003	0,003	0,003	0,003	0,003
45	0,002	0,002	0,002	0,002	0,002	0,002	0,002	0,002	0,002	0,002
46	0,001	0,001	0,001	0,001	0,001	0,001	0,001	0,001	0,001	0,001
47	0,001	0,001	0,001	0,001	0,001	0,001	0,001	0,001	0,001	0,001
48	0,000	0,000	0,000	0,000	0,000	0,000	0,000	0,000	0,000	0,000
49	0,000	0,000	0,000	0,000	0,000	0,000	0,000	0,000	0,000	0,000
Gjithsej	2,310	2,250	2,200	2,170	2,140	2,110	2,080	2,050	2,030	2,010

vazhdon... **Tabela 7.**Koeficientët specifikë të lindshmërisë. Projektionet, Shqipëria për vitet (2001-2010).

Lindshmëri e lartë

Mosha	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019	2020
15	0,001	0,001	0,001	0,001	0,001	0,001	0,001	0,001	0,001	0,001
16	0,003	0,003	0,003	0,003	0,003	0,003	0,003	0,003	0,003	0,003
17	0,012	0,011	0,011	0,011	0,011	0,011	0,011	0,011	0,011	0,010
18	0,021	0,021	0,021	0,020	0,020	0,020	0,020	0,020	0,019	0,019
19	0,043	0,043	0,042	0,042	0,041	0,041	0,041	0,040	0,040	0,039
20	0,072	0,071	0,070	0,070	0,069	0,068	0,068	0,067	0,066	0,065
21	0,096	0,095	0,094	0,093	0,092	0,091	0,090	0,089	0,088	0,087
22	0,120	0,119	0,117	0,116	0,115	0,114	0,113	0,111	0,110	0,109
23	0,139	0,138	0,136	0,135	0,133	0,132	0,131	0,129	0,128	0,126
24	0,153	0,152	0,150	0,149	0,147	0,146	0,144	0,143	0,141	0,140
25	0,161	0,159	0,158	0,156	0,155	0,153	0,151	0,150	0,148	0,147
26	0,155	0,154	0,152	0,151	0,149	0,148	0,146	0,144	0,143	0,141
27	0,147	0,145	0,144	0,142	0,141	0,139	0,138	0,136	0,135	0,133
28	0,134	0,133	0,132	0,130	0,129	0,128	0,126	0,125	0,123	0,122
29	0,122	0,121	0,119	0,118	0,117	0,116	0,114	0,113	0,112	0,111
30	0,110	0,109	0,108	0,107	0,106	0,105	0,104	0,103	0,101	0,100
31	0,101	0,100	0,099	0,098	0,097	0,096	0,095	0,094	0,093	0,092
32	0,086	0,085	0,085	0,084	0,083	0,082	0,081	0,080	0,079	0,079
33	0,072	0,071	0,070	0,070	0,069	0,068	0,068	0,067	0,066	0,065
34	0,058	0,057	0,056	0,056	0,055	0,055	0,054	0,053	0,053	0,052
35	0,046	0,046	0,045	0,045	0,044	0,044	0,043	0,043	0,042	0,042
36	0,036	0,036	0,036	0,035	0,035	0,035	0,034	0,034	0,034	0,033
37	0,029	0,028	0,028	0,028	0,028	0,027	0,027	0,027	0,026	0,026
38	0,022	0,022	0,022	0,021	0,021	0,021	0,021	0,021	0,020	0,020
39	0,015	0,015	0,015	0,015	0,015	0,015	0,014	0,014	0,014	0,014
40	0,012	0,011	0,011	0,011	0,011	0,011	0,011	0,011	0,011	0,010
41	0,008	0,008	0,008	0,007	0,007	0,007	0,007	0,007	0,007	0,007
42	0,006	0,006	0,006	0,006	0,006	0,005	0,005	0,005	0,005	0,005
43	0,004	0,004	0,004	0,004	0,004	0,004	0,004	0,004	0,004	0,003
44	0,003	0,003	0,003	0,003	0,003	0,003	0,003	0,003	0,003	0,003
45	0,002	0,002	0,002	0,002	0,002	0,002	0,002	0,002	0,002	0,002
46	0,001	0,001	0,001	0,001	0,001	0,001	0,001	0,001	0,001	0,001
47	0,001	0,001	0,001	0,001	0,001	0,001	0,001	0,001	0,001	0,001
48	0,000	0,000	0,000	0,000	0,000	0,000	0,000	0,000	0,000	0,000
49	0,000	0,000	0,000	0,000	0,000	0,000	0,000	0,000	0,000	0,000
Gjithsej	1,990	1,970	1,950	1,930	1,910	1,890	1,870	1,850	1,830	1,810



Tabela 8. Koeficientët specifikë të lindshmërisë. Projektionet, Shqipëria për vitet (2001-2010).

Lindshmëri e ulët

Mosha	2001	2002	2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010
15	0,001	0,001	0,001	0,001	0,001	0,001	0,001	0,001	0,001	0,001
16	0,003	0,003	0,003	0,003	0,003	0,003	0,003	0,003	0,003	0,002
17	0,013	0,013	0,012	0,012	0,011	0,011	0,011	0,010	0,010	0,010
18	0,024	0,023	0,022	0,022	0,021	0,020	0,020	0,019	0,019	0,018
19	0,050	0,048	0,046	0,044	0,043	0,041	0,040	0,039	0,038	0,037
20	0,083	0,080	0,077	0,074	0,072	0,069	0,067	0,065	0,063	0,061
21	0,111	0,107	0,102	0,099	0,095	0,092	0,089	0,087	0,084	0,082
22	0,139	0,133	0,128	0,123	0,119	0,115	0,111	0,108	0,105	0,102
23	0,161	0,154	0,148	0,143	0,138	0,133	0,129	0,126	0,122	0,119
24	0,178	0,170	0,163	0,158	0,153	0,147	0,143	0,139	0,135	0,131
25	0,187	0,179	0,172	0,166	0,160	0,155	0,150	0,146	0,142	0,138
26	0,180	0,173	0,166	0,160	0,155	0,149	0,144	0,141	0,137	0,133
27	0,170	0,163	0,156	0,151	0,146	0,141	0,136	0,133	0,129	0,125
28	0,156	0,149	0,143	0,138	0,134	0,129	0,125	0,121	0,118	0,115
29	0,141	0,135	0,130	0,125	0,121	0,117	0,113	0,110	0,107	0,104
30	0,128	0,122	0,117	0,114	0,110	0,106	0,103	0,100	0,097	0,094
31	0,117	0,112	0,107	0,104	0,100	0,097	0,094	0,091	0,089	0,086
32	0,100	0,096	0,092	0,089	0,086	0,083	0,080	0,078	0,076	0,074
33	0,083	0,080	0,077	0,074	0,072	0,069	0,067	0,065	0,063	0,061
34	0,067	0,064	0,061	0,059	0,057	0,055	0,053	0,052	0,051	0,049
35	0,053	0,051	0,049	0,047	0,046	0,044	0,043	0,042	0,040	0,039
36	0,042	0,040	0,039	0,038	0,036	0,035	0,034	0,033	0,032	0,031
37	0,033	0,032	0,031	0,030	0,029	0,028	0,027	0,026	0,025	0,025
38	0,026	0,024	0,023	0,023	0,022	0,021	0,021	0,020	0,019	0,019
39	0,018	0,017	0,016	0,016	0,015	0,015	0,014	0,014	0,013	0,013
40	0,013	0,013	0,012	0,012	0,011	0,011	0,011	0,010	0,010	0,010
41	0,009	0,009	0,008	0,008	0,008	0,007	0,007	0,007	0,007	0,007
42	0,007	0,006	0,006	0,006	0,006	0,006	0,005	0,005	0,005	0,005
43	0,004	0,004	0,004	0,004	0,004	0,004	0,004	0,003	0,003	0,003
44	0,003	0,003	0,003	0,003	0,003	0,003	0,003	0,003	0,003	0,002
45	0,002	0,002	0,002	0,002	0,002	0,002	0,002	0,002	0,002	0,002
46	0,001	0,001	0,001	0,001	0,001	0,001	0,001	0,001	0,001	0,001
47	0,001	0,001	0,001	0,001	0,001	0,001	0,001	0,001	0,001	0,001
48	0,000	0,000	0,000	0,000	0,000	0,000	0,000	0,000	0,000	0,000
49	0,000	0,000	0,000	0,000	0,000	0,000	0,000	0,000	0,000	0,000
Gjithsej	2,310	2,210	2,120	2,050	1,980	1,910	1,850	1,800	1,750	1,700

vazhdim... **Tabela 8.** Koeficientët specifikë të lindshmërisë. Projektionet, Shqipëria për vitet (2001-2010).

Lindshmëri e ulët.

Mosha	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019	2020
15	0,001	0,001	0,001	0,001	0,001	0,001	0,001	0,001	0,001	0,001
16	0,002	0,002	0,002	0,002	0,002	0,002	0,002	0,002	0,002	0,002
17	0,010	0,009	0,009	0,009	0,009	0,009	0,008	0,008	0,008	0,008
18	0,017	0,017	0,017	0,016	0,016	0,016	0,015	0,015	0,015	0,015
19	0,036	0,035	0,034	0,033	0,033	0,032	0,031	0,031	0,031	0,031
20	0,060	0,058	0,057	0,055	0,054	0,053	0,052	0,052	0,051	0,051
21	0,080	0,078	0,076	0,074	0,072	0,071	0,070	0,069	0,068	0,068
22	0,099	0,097	0,095	0,092	0,090	0,089	0,087	0,086	0,086	0,085
23	0,115	0,113	0,110	0,107	0,105	0,103	0,101	0,100	0,099	0,099
24	0,127	0,124	0,121	0,118	0,116	0,113	0,112	0,110	0,109	0,109
25	0,134	0,130	0,127	0,124	0,121	0,119	0,117	0,116	0,115	0,114
26	0,129	0,126	0,123	0,119	0,117	0,115	0,113	0,112	0,111	0,110
27	0,122	0,119	0,116	0,113	0,111	0,108	0,107	0,105	0,105	0,104
28	0,111	0,109	0,106	0,103	0,101	0,099	0,098	0,096	0,096	0,095
29	0,101	0,099	0,096	0,094	0,092	0,090	0,089	0,088	0,087	0,086
30	0,091	0,089	0,087	0,085	0,083	0,081	0,080	0,079	0,079	0,078
31	0,083	0,081	0,079	0,077	0,076	0,074	0,073	0,072	0,072	0,071
32	0,072	0,070	0,068	0,066	0,065	0,064	0,063	0,062	0,062	0,061
33	0,060	0,058	0,057	0,055	0,054	0,053	0,052	0,052	0,051	0,051
34	0,048	0,047	0,045	0,044	0,043	0,043	0,042	0,041	0,041	0,041
35	0,038	0,037	0,036	0,035	0,035	0,034	0,034	0,033	0,033	0,033
36	0,030	0,029	0,029	0,028	0,027	0,027	0,027	0,026	0,026	0,026
37	0,024	0,023	0,023	0,022	0,022	0,021	0,021	0,021	0,021	0,020
38	0,018	0,018	0,017	0,017	0,017	0,016	0,016	0,016	0,016	0,016
39	0,013	0,012	0,012	0,012	0,012	0,011	0,011	0,011	0,011	0,011
40	0,010	0,009	0,009	0,009	0,009	0,009	0,008	0,008	0,008	0,008
41	0,006	0,006	0,006	0,006	0,006	0,006	0,006	0,006	0,005	0,005
42	0,005	0,005	0,005	0,004	0,004	0,004	0,004	0,004	0,004	0,004
43	0,003	0,003	0,003	0,003	0,003	0,003	0,003	0,003	0,003	0,003
44	0,002	0,002	0,002	0,002	0,002	0,002	0,002	0,002	0,002	0,002
45	0,002	0,002	0,002	0,001	0,001	0,001	0,001	0,001	0,001	0,001
46	0,001	0,001	0,001	0,001	0,001	0,001	0,001	0,001	0,001	0,001
47	0,001	0,001	0,001	0,001	0,001	0,001	0,001	0,001	0,001	0,001
48	0,000	0,000	0,000	0,000	0,000	0,000	0,000	0,000	0,000	0,000
49	0,000	0,000	0,000	0,000	0,000	0,000	0,000	0,000	0,000	0,000
Gjithsej	1,650	1,610	1,570	1,530	1,500	1,470	1,450	1,430	1,420	1,410



Tabela 9. Koefficientët specifikë të lindshmërisë(*5) sipas Rajoneve. Projektionet e Shqipërisë, sipas periudhave

Periudha	Mosha							Gjithsej
	15-19	20-24	25-29	30-34	35-39	40-44	45-49	
Veri								
2001-05	0,117	0,851	1,055	0,626	0,218	0,046	0,006	2,920
2006-10	0,108	0,790	0,980	0,581	0,202	0,043	0,005	2,710
2011-15	0,103	0,749	0,929	0,551	0,192	0,041	0,005	2,570
2016-20	0,098	0,711	0,882	0,523	0,182	0,039	0,005	2,440
Qendër (përfshirë Tiranën-Durrësin)								
2001-05	0,087	0,633	0,784	0,465	0,162	0,035	0,004	2,170
2006-10	0,080	0,586	0,727	0,431	0,150	0,032	0,004	2,010
2011-15	0,076	0,557	0,690	0,410	0,143	0,030	0,004	1,910
2016-20	0,072	0,528	0,654	0,388	0,135	0,029	0,003	1,810
Jug								
2001-05	0,082	0,595	0,737	0,437	0,152	0,032	0,004	2,040
2006-10	0,076	0,554	0,687	0,407	0,142	0,030	0,004	1,900
2011-15	0,072	0,525	0,651	0,386	0,134	0,029	0,003	1,800
2016-20	0,068	0,499	0,618	0,367	0,128	0,027	0,003	1,710

Tabela 10. Mundësia e emigracionit nga vendi dhe nga rajonet.
Projektionet e Shqipërisë, sipas periudhave

Vendi,rajonet	2001-2005	2006-2010	2011-2015	2016-2020
Emigrimi i jashtëm				
Shqipëria, emigracion i ulët	0	0	0	0
Shqipëria, emigracion i lartë	0.005	0.005	0.005	0.005
Emigracion i brendshëm				
Veri	0.02	0.02	0.02	0.02
Qendër*	0.002	0.002	0.002	0.002
Jug	0.007	0.007	0.007	0.007

Mundësia e emigrimit supozohet të jetë e njëjtë për meshkujt dhe femrat dhe për çdo moshë.

Emigracioni i brendshëm midis rajoneve rezulton i njëjtë me numrin e emigranteve në rrethet Tiranë dhe Durrës.

2

**Rezultatet kryesore
dhe analiza****Rezultatet
kryesore dhe
analiza****2.1 Popullsia e përgjithshme dhe
rritja e saj (2001-2021)****2.1.1 Popullsia shqiptare në 2021**

Parashikimet tregojnë një **rritje të numrit të popullsisë shqiptare gjatë njëzet viteve të ardhshme**, pavarësisht nga grupi i parashikimeve të marra në konsideratë (Tabela 11). Kjo do të ndryshojë nga e kaluara e afërt ku popullsia përjetoi një rënie të numrit të saj që pas Luftës së Dytë Botërore.

Pas dekadash rritjeje të qëndrueshme, numri i përgjithshëm i banorëve të Shqipërisë është ulur me 113,000 banorë në periudhën midis dy regjistrimeve të fundit 1989 dhe 2001. Faktori kryesor për këtë rënie ka qenë emigracioni i jashtëm, i cili me siguri i ka kaluar 600,000 vetët vaçanërisht pas vitit 1995. Ka tepër të ngjarë që për disa vite me radhë gjatë kësaj periudhe të ketë pasur rënie të madhe të popullsisë. Ulja e vazhdueshme e lindshmërisë pas viteve 60-të ka qenë një faktor tjetër dytësor për ngadalësimin e rritjes demografike, me një shkallë lindjesh prej 2.3 fëmijë për grua në 2001, tri herë më pak se dyzet vjet më parë.

Tetë grupet e parashikimeve të popullsisë që kemi krijuar deri në 2021 me anë të një kombinimi supozimesh për tendencat e ardhshme të migracionit, lindshmërisë dhe vdekshmërisë, vënë në dukje se popullsia ka rifilluar të rritet. Në një interval kohor njëzet vjeçar, numri i përgjithshëm i banorëve do të rritej nga 3,063,000 të paktën deri në 3,221,000 ose maksimumi 3,702,000. Rritja e përgjithshme do të ishte jo më pak se + 158,000 dhe jo më shumë se + 659,000.

Rritja e popullsisë do të ishte minimale po të ruhej një shkallë e madhe emigracioni, në rast se lindshmëria do të binte në nivele shumë të vogla dhe në rast se vdekshmëria nuk do të rritej. Në atë rast, popullsia e Shqipërisë në 2021 do të ishte pak më shumë se në 1989 dhe ndoshta edhe më pak se në 1995 para largimit në masë të emigrantëve. Në të kundërtën, në rast se emigracioni i jashtëm do të ndërpritej, në rast se rënia e lindshmërisë do të ishte e kufizuar, dhe në rast se vdekshmëria do të ishte më e favorshme, popullsia e Shqipërisë në 2021 do të arrinte pikun më të lartë në historinë e saj, mbi 3,7 milionë. Megjithatë, edhe në këtë rast, rritja e popullsisë gjatë dy dekadave të ardhshme do të ishte më e vogël se në disa periudha të së kaluarës, për shembull gjatë dhjetë vjetëve nga 1969 deri në 1979, dhe nga 1979 në 1989, numri i banorëve u rrit



Tabela 11. Projektionet e Popullsisë së Shqipërisë
Popullsia gjithsej per çdo vit sipas hipotezave (supozimeve) të ndryshme

POPULLSIA GJITHSEJ (1 Janar)								
Migracion	Pa migracion (PaM)				Migracion (Migr)			
Lindshmëri	Lindshmëri e Lartë (LL)		Lindshmëri e Ulët (LU)		Lindshmëri e Lartë (LL)		Lindshmëri e Ulët (LU)	
Vdekshmëri	Ulët (VU)	Lartë (VL)	Ulët (VU)	Lartë (VL)	Ulët (VU)	Lartë (VL)	Ulët (VU)	Lartë (VL)
2001	3063318	3063318	3063318	3063318	3063318	3063318	3063318	3063318
2002	3099647	3099647	3099647	3099647	3084148	3084148	3084148	3084148
2003	3134966	3134966	3134044	3134044	3103694	3103694	3102781	3102781
2004	3169607	3169607	3166811	3166811	3122298	3122298	3119544	3119544
2005	3204140	3204140	3198476	3198476	3140532	3140532	3134982	3134982
2006	3238650	3238650	3229075	3229075	3158485	3158485	3149147	3149147
2007	3273686	3273165	3259070	3258579	3176689	3176183	3162506	3162030
2008	3308712	3307661	3288153	3287171	3194622	3193608	3174773	3173825
2009	3343657	3342069	3316484	3315008	3212220	3210694	3186115	3184697
2010	3378688	3376552	3343934	3341962	3229643	3227601	3196422	3194538
2011	3413683	3410990	3370359	3367889	3246778	3244217	3205573	3203224
2012	3449026	3445216	3396067	3392612	3263991	3260385	3213873	3210604
2013	3483981	3479038	3420667	3416225	3280584	3275930	3220967	3216785
2014	3518339	3512253	3443970	3438543	3296372	3290670	3226695	3221611
2015	3551898	3544659	3465797	3459389	3311174	3304426	3230910	3224936
2016	3584463	3576067	3486282	3478899	3324824	3317037	3233757	3226908
2017	3616118	3606277	3505505	3496911	3337417	3328334	3235330	3227398
2018	3646358	3635073	3523348	3513552	3348500	3338137	3235539	3226543
2019	3674994	3662274	3539665	3528677	3357924	3346301	3234271	3224231
2020	3701896	3687752	3554649	3542480	3365593	3352734	3231723	3220660
2021	3726945	3711393	3568194	3554857	3371425	3357357	3227818	3215753

me më shumë se gjysëm milioni, kurse pas njëzet vjetësh ky numur do të arrijë 1.1 milion.

2.1.2 Roli i emigracionit, lindshmërisë dhe vdekshmërisë

Ka një hendek të madh midis grupeve të ndryshme të parashikimeve (Figura 3). Krahasimet e zgjedhura dy nga dy nxjerrin në pah ndikimin e faktorëve të ndryshëm të rritjes së popullsisë, migracioni i jashtëm, lindshmëria dhe vdekshmëria. **Migracioni i jashtëm është vendimtar për sa i përket një incidence më të madhe, shkalla e rënies së lindshmërisë vjen e dyta, kurse vdekshmëria ka vetëm një rëndësi të dorës së fundit.**

Në rast se lindshmëria do të ulej më ngadalë dhe në rast se vdekshmëria do të paraqiste një farë rënie, gjatë njëzetë vjetëve të ardhshme, pra në 2021 popullsia do të ishte

3,727,000 me kusht që të mos kishte ndonjë largim të popullsisë, dhe vetëm 3,371,000 në rast se 0.5 përqind e shqiptarëve do të largoheshin nga vendi çdo vit. Diferenca (356,000 = 3,727,000 – 3,371,000) mat influencën numerike të migracionit në zhvillimin e ardhshëm të popullsisë së vendit. Rezultate disi më të ndryshme përftohen në rast se bëjmë krahasime të tjera (p.sh. 339,000 po të krahasojmë rezultatet e parashikimeve pa dhe me emigracionin, kur rënia e lindshmërisë është e shpejtë dhe rritja e vdekshmërisë është zero), por rendi i madhësisë është i ngjashëm, një diferencë prej 350,000 në numrin e banorëve në 2021 i dedikohet flukseve të emigracionit gjatë dy dekadave të ardhshme.

Në rast se nuk ka emigracion dhe ndryshime në vdekshmëri, popullsia në 2021 do të jetë 3,711,000 me kusht që lindshmëria të ulej

Figura 3. Projektionet e Popullsisë së Shqipërisë
Popullsia gjithsej sipas supozimeve të ndryshme





Figura 4. Projektionet e Popullsisë së Shqipërisë
Koeficientët e rritjes vjetore sipas supozimeve të ndryshme





më ngadalë deri në 1.8 fëmijë për grua në vit, por vetëm 3,555,000 në rast se ajo do të ulej me më shumë shpejtësi deri në 1.4 fëmijë. Diferenca (156,000) mat ndikimin numerik të lindshmërisë ndaj zhvillimeve të ardhshme të popullsisë së vendit. Krahasime të tjera japin rezultate disi të ndryshme, por renditja e madhësisë është rreth 150,000 ku më pak se gjysma i atribuohet migracionit të jashtëm.

E matur në të njëjtën mënyrë, shpeshtësia e supozimeve të vdekshmërisë del se është minimale. Në varësi a do të ketë apo jo një rritje të rreziqeve të vdekshmërisë, numri i banorëve në 2021 nuk do të ndryshojë me më shumë se 15,000 ose dhjetë herë më pak se ndikimi i supozimit të lindshmërisë dhe më shumë se njëzet herë më pak se ai i emigracionit. Do ta konfirmojmë atë me rezultate të tjera më poshtë, por konkluzioni praktik është se grupet e parashikimeve të popullsisë mund të ulen nga tetë në katër, pavarësisht nga dallimet midis parashikimeve me apo pa ndryshime të koeficientëve të vdekshmërisë në njëzet vitet e ardhshme.

2.1.3 Rritja e popullsisë dhe faktorët e saj

Shkalla vjetore e rritjes së popullsisë është ngadalësuar progresivisht, nga 2.9 për 100 në vitet 50-të në 2.1 në vitet 80-të, para rënies së papritur në fund të mijëvjeçarit. **Shkalla e rritjes në të ardhmen do të jetë përsëri pozitive në shkallë globale**, por pak më pak se më parë. **Ajo do të bjerë me kalimin e kohës**, duke arritur bile nivele negative në fund të periudhës njëzet vjeçare në disa grupe supozimesh (Figura 4).

Me një lindshmëri që ulet ngadalë dhe pa emigracion (pavarësisht nga supozimet e vdekshmërisë), shkalla vjetore e rritjes së popullsisë do të zhduket progresivisht, ndërsa do të mbetet pak mbi 1 për 100 në dekadën e parë. Do të bjerë më me shpejtësi në gjysmën e dytë të periudhës së parashikimit, duke rënë

nën 0.7 për 100 në 2020. Duhet t'i referohemi piramidës së moshës në regjistrimin e 2001 për ta shpjeguar këtë proces me dy faza, adoleshentët me moshë 10 deri në 15 vjeç ishin relativisht të shumtë në numër, krahasuar me të rriturit në të njëzetat dhe të tridhjetat, sepse të dy këto grupe ishin prekur shumë nga emigracioni, prindërit e rinj ishin larguar nga vendi me fëmijë të vegjël në një numër shumë më të madh se prindërit më të mëdhenj në moshë me fëmijë të rritur. Në vitet e para të mijëvjeçarit të ri, këta adoleshentë do të arrijnë moshat fertile dhe numri i tyre relativisht i madh do të kompensojë pjesërisht rënien e ngadaltë por të vazhdueshme të lindshmërisë; në vitet e mëvonshme, të porsafuturit në moshat fertile do të dalin nga brezat më të rinj, të lindur pas 1990 dhe do të jenë shumë më të paktë në numër.

Kur supozimet tregojnë një rënie shumë të shpejtë të shkallës së lindshmërisë dhe mungesën e migracionit, kompensimi që vjen nga ky efekt strukturor nuk është shumë i madh; shkalla e rritjes vjetore do të bjerë vazhdimisht, pothuaj në mënyrë lineare nga 1.2 për 100 në 2001 në 0.4 në 2020. Gjatë vitit të fundit, diferenca midis dy grupeve të supozimeve ($0.3\% = 0.7 - 0.4$) mat ndikimin e niveleve të lindshmërisë në shkallën e rritjes vjetore, në varësi të faktit në se në fund të parashikimit lindshmëria do të jetë 1.8 apo 1.4 lindje për grua.

Kur migracioni i jashtëm mendohet se është 0.5 përqind të totalit të popullsisë çdo vit, në vend të zeros, shkalla e rritjes vjetore ulet me të njëjtën ritëm gjatë gjithë periudhës së parashikimit, pa ndonjë ndryshim të dukshëm në formën e tendencës së kohës. Me një rënie relativisht të pakët të lindshmërisë, rritja e popullsisë do të mbetet mbi 0.5 përqind në dekadën e parë, para se të bjerë në 0.2 përqind. Në fund të periudhës, rritja vjetore e popullsisë do të ishte afër zeros.

Do të ishte më e dukshme në rast se lindshmëria do të ulet më me shpejtësi. Një pakësim i vazhdueshëm dhe i shpejtë i shkallës së rritjes së popullsisë do të rezultonte në vlera negative nga 2018 e këtej dhe minus 0.1 përqind në 2020. Popullsia e Shqipërisë do të arrinte maksimumin prej rreth 3,230,000 banorë (pak më shumë ose pak më pak, në varësi të tendencave të vdekshmërisë) përpara se të fillonte të binte. Do të ishte vetëm 50,000 më shumë se në 1989 dhe me siguri më pak se në 1995.

2.1.4 Popullsia dhe rritja e saj në të ardhshmen: një vështrim i përgjithshëm


Shkurtimisht, Shqipëria, e cila ishte 3.07 milionë gjatë regjistrimit të fundit, do të rritet me rreth 10% në 2010, në rast se nuk ka emigracion dhe në rast se lindshmëria ulet në mënyrë të moderuar. Do të duhen edhe një apo dy vjet të tjerë në rast se lindshmëria ulet më me shpejtësi (migracioni të mbetet zero). Kufiri prej 10% do të arrihet vetëm nga fundi i periudhës njëzetvjeçare të parashikuar, në rast të një emigracioni të madh (dhe një rënie të vogël të lindshmërisë). Ky numër nuk do të arrihet kurrë, po qe se emigracioni dhe lindshmëria e ulët kombinojnë pasojat e tyre dhe të dyja kontribuojnë për një kufizim të rritjes demografike: popullsia e Shqipërisë do të arrijë kulmin me 5% mbi rezultatet e regjistrimit të popullsisë.

2.2 POPULLSIA SIPAS MOSHËS

2.2.1 Popullsia në grupmoshat e mëdha

Krahasuar me pjesën tjetër të Evropës, **popullsia e Shqipërisë është e "re"**, me një përqindje relativisht të madhe personash nën 15 vjeç dhe me përqindje të ulët të të moshuarve me moshë 65 vjeç ose më

Figura 5. Projektionet e Popullsisë së Shqipërisë
Struktura moshore sipas supozimeve të ndryshme



shumë. Gjatë njëzet viteve të ardhshme, kjo veçori do të ulet më ngadalë. **Pesha specifike e të rinjve do të bjerë në mënyrë të dukshme dhe ajo e personave me moshë më të madhe do të rritet progresivisht.**

Në 2001 29.5% e shqiptarëve ishin fëmijë nën moshën 15 vjeç. Në Francë, në të njëjtin vit, përqindja ishte vetëm 18.8 përqind. Këta tregues janë të kundërt për moshat 65 ose më shumë (Shqipëria: 7.4%, Franca: 16.1%). Kjo është rrjedhojë e historive shumë të ndryshme të të dy popullsisë, kryesisht në fushën e lindshmërisë: në 1960, gratë shqiptare kishin ende një mesatare prej 7 fëmijësh, që tani janë pakësuar në 2.3; Franca e kaloi tranzicionin e saj në lindshmërinë e ulët dy shekuj më parë dhe që atëhere ka kaluar disa dekada me lindshmëri po kaq të ulët, bile edhe më të ulët se ajo e Shqipërisë sot.

Gjatë njëzet viteve të ardhshme, përqindja e fëmijëve të rinj në Shqipëri do të ulet në mënyrë të dukshme në 21.9% në rast se lindshmëria ulet në mënyrë të moderuar dhe në 18.7% në rast se kjo lëvizje përshpejtohet.



Në rastin e fundit, niveli do të jetë i njëjti me atë të Francës. Sipas të dy supozimeve, ulja është shumë e madhe, pak më pak ose pak më shumë se një e treta. Ndryshimet janë në drejtimin e kundërt në moshat e vjetra, përqindja e popullsisë 65+ ka tendencë drejt 11.2% (lindshmëri e madhe) ose 11.7% (lindshmëri e ulët) në 2021. Vihet re se rezultatet mbeten larg atyre të Francës dhe dallojnë pak sipas supozimeve të lindshmërisë. (Figura 5)

Popullsia e Shqipërisë do të vazhdojë progresionin e saj drejt plakjes në dy dekadat e ardhshme. Krahasuar me standartet evropiane, përqindja e fëmijëve do të vazhdojë të jetë e pakët, siç vazhdon të jetë tashmë në shumë vende, por do të ruajë një përqindje relativisht të ulët të të moshuarve. Ky është mekanizmi i kohortëve (brezave); duhet më shumë kohë që plakja të arrijë moshat më të larta se sa të prekë moshat më të reja. Me afat të gjatë, pritet të ndodhë një plakje më e madhe, veçanërisht nëpërmjet rritjes së peshës specifike të të moshuarve.

Nuk është për t'u çuditur se ndryshimet në strukturën e moshës janë më të dallueshme kur rënia e lindshmërisë është më e madhe. Dhe e kundërta, vdekshmëria nuk ka ndonjë ndikim tek ndryshimet; rritja e të mbijetuarit mendohet se shpërndahet në gjithë jetëgjatësinë. Kjo situatë ndryshon pak nga ajo e pjesës më të përparuar të vendeve të Evropës Perëndimore, kur përparimet përqëndrohen ekskluzivisht te moshat më të larta; në Shqipëri pritet të kihen përfitime në moshat më të reja (veçanërisht tek vdekshmëria foshnjore), të cilat janë supozuar se paraqesin tabelat më të favorshme të jetës. As migracioni i jashtëm nuk mendohet se ka ndonjë efekt, i cili për mendimin tonë prek të gjitha moshat siç ka ndodhur me tendencat më të fundit në lëvizjet e brendshme të popullsisë. Do të ndryshonte puna po qe se do të vihej re se emigrantët janë kryesisht të rritur me moshë të re, me fëmijë të rinj, siç qe rasti në vitet 90-të në një periudhë trazirash ekonomike dhe politike.

2.2.2 Piramidat e moshës


Shpërndarja e popullsisë sipas gjinisë dhe moshës, siç ilustron në piramidat e moshës, na jep një përfytyrim më sugjestionues të faktorëve në veprim gjatë njëzet vjetëve të tjerë (shih më poshtë). Në vitin 2021, fëmijët e lindur gjatë periudhës së parashikimit si pasojë e supozimeve të lindshmërisë dhe të gjinisë do të jenë nën moshën 20 vjeç. Ata përbëjnë edhe bazën e piramidave. Personat që janë të pranishëm në 2001 në të dhënat e regjistrimit të popullsisë do të jenë mbi 20 vjet më të mëdhenj, pra të gjithë do të jenë plakur me njëzet vjet dhe secili grup individësh do të ketë humbur disa nga anëtarët e tij për shkak të vdekjeve ose të emigrimit.

Supozimet e ndryshme të vdekshmërisë kanë një efekt kaq të parëndësishëm sa që piramidat nuk i pasqyrojnë fare ato. Ne e kemi kufizuar përfaqësimin në një grup të vetëm supozimesh për vdekshmërinë (VL: vdekshmëri e lartë), kur tabela më e fundit për jetëgjatësinë në Shqipëri mendohet se do të zbatohet vazhdimisht në të ardhmen, pa pasur rritje në asnjë moshë. (Figura 6)

Efekti i migracionit është më i lehtë për t'u dalluar, edhe pse i kufizuar. Piramidat e moshës pasqyrojnë parashikime të bëra pa migracion (Pa Mig); parashikimet e krahut të majtë supozojnë se 0.5% e popullsisë së Shqipërisë (pra. rreth 15,000 persona ose më shumë) do të largohen nga vendi çdo vit (Migr). Diferenca nuk qëndron në formën e piramidave, por në **volumin** e tyre: popullsia në secilën moshë është në numër më të madh kur nuk ka migracion, por teprica është propocionale me numrat.

Lindshmëria luan një rol vendimtar. Për shkak të rënies së numrit të saj, pavarësisht nga thellësia dhe shpejtësia, numri i fëmijëve të rinj, të lindur në 2000, do të jetë më i vogël se numri i të rriturve të lindur para disa vjetësh. Kur lindshmëria mendohet se bie më ngadalë, numri i këtyre fëmijëve ndryshon pak,

Figura 6. Projektionet e Popullsisë së Shqipërisë
Piramadat e moshës në 2021 sipas supozimeve të ndryshme



nga një moshë në tjetrën, është pak më i lartë nga mosha 5 deri në 10 vjeç, pak më i vogël nën 5 dhe mbi 10 vjeç. Është një jehonë e numrit relativisht të lartë të personave të numëruar në 2001, kur ata ishin me moshe 10 deri në 15, të cilët do të arrijnë moshën e të qënurit prindër në fillim të viteve 2010. Kur lindshmëria mendohet të bjerë me shpejtësi dhe shumë, ky efekt nuk do të shihet më, numri i fëmijëve do të ulet në vazhdimësi dhe ata me moshë më të re do të jenë më të paktë

në numër. **Baza e piramidës bëhet gjithnjë e më e ngushtë.**

Në të gjitha rastet, forma e piramidave do të bëhet gjithnjë e më e **pabarabartë**. Krahasimi i brezave (kohorteve) më të vjetra me ato më të reja, ka një deficit njerëzish të lindur në vitet shtatëdhjetë, për shkak të vërshimeve masive të emigrantëve në gjysmën e dytë të viteve 90. Ata që kanë qenë të rritur në moshë të re në kohën e regjistrimit të popullsisë, do të rriten



në moshë gjatë gjithë periudhës së parashikimit. Do të zëvendësohen në rininë e hershme nga anëtarë më të rinj dhe në numër më të madh të lindur në vitet 80 dhe 90, dhe do të ndikohen pak nga emigracioni. Por brezi i ri, po ashtu do të ketë mungesa në numër jo për shkak të migracionit, por për shkak të lindshmërisë së ulët.

Këto parregullsi do të krijojnë rritje dhe zvoglime në forcat e punës, në kërkesën për strehim, ose në nevojën për arsimim, kurse parashikimet e popullsisë do të ndihmojnë për t'i identifikuar dhe parashikuar ato.

2.2.3 Çështje specifike që lidhen me moshën

Në 2001 kishte 59,000 fëmijë në moshë 6 vjeç, që për shkak të moshës, sapo kishin hyrë në sistemin e shkollës, të cilët në të ardhmen, do të vazhdojnë të qëndrojnë në sistem, në fillim në filllore, pastaj në tetëvjeçare. Ndërsa në 2002, numri i tyre është 62,000. Ndikimi i përgjithshëm në sistem do të varet po ashtu edhe nga numri fillestar (59 mijë dhe 62 mijë) si edhe nga

kohëzgjatja e programit mësimor (8 vjet? 9 vjet? Më shumë?). Parashikimet na informojnë për të parin, por natyrisht jo për të dytin (Figura 7)

Numri i përgjithshëm i nxënësve të rinj do të përcaktohet së pari nga numri i fëmijëve me moshë 5, 4, 3 e tjera në 2001, të cilët progresivisht do të hyjnë në shkollë gjatë viteve të para të parashikimit. Në periudhën e mëpasme, numri do të ndikohet nga supozimet e lindshmërisë, nxënësit e rinj do të pasqyrojnë lindjet e reja gjashtë vjet më parë. Edhe migracioni luan një farë roli, numri i fëmijëve ulet në rastin e një emigracioni të madh, ose nga që ulet numri i lindjeve, ose nga ulja e numrit të fëmijëve që janë ende në vend.


Numri i nxënësve të rinj do të ulet deri në 2005 në 52,000 (pa migracion) ose 51,000 (me migracion). Pastaj do të rritet ngadalë deri në fund të periudhës së parashikimit, vetëm në rast se lindshmëria ulet, por më ngadalë dhe në rast se nuk emigron askush. Edhe me këto supozime, numri do të vazhdojë të rritet deri në 56,000 shifër që është shumë nën shifrat e viteve 2001-2002. Pika kulminante do të reduktohet në 51,000 në rast se ka emigracion. (Figura 7)

Në rast se lindshmëria bie më shumë, numri i nxënësve të rinj do të pakësohet gjatë gjithë periudhës së parashikimit në nivele deri në 44,000 (pa migracion) ose edhe 40,000 (me migracion). Ky numër do të ulet me të paktën 30% krahasuar me vitet e para të Mijëvjeçarit.

Mosha 20 vjeç është një pengesë më pak formale për **hyrjen në forcën e punës**, por numri i personave në atë moshë të jep një ide për **dinamikën e popullsisë aktive**, veçanërisht në rast se kjo kombinohet me informacione për ata që largohen nga forca e punës rreth moshës së pensionit.

Personat që arrijnë moshën 20 vjeç gjatë periudhës së parashikimit kanë lindur të gjithë

Figure 7. Projektionet e Popullsisë së Shqipërisë. Popullsia për disa moshë, sipas supozimeve të ndryshme



ndërkohë. Numri i tyre ndikohet vetëm nga supozimi i migracionit, kurse diferencat e vdekshmërisë pothuaj nuk kanë asnjë ndikim. Luhajtet nga njeri vit në tjetrin në fakt janë një pasojë e ndryshimeve në numrin e personave të numëruar në 2001 nga njera moshë në tjetrën nën moshën 20 vjeç.

Numri është 50,000 në 2001. Ai do të rritet deri në 65,000 gjatë pesë viteve të ardhshme (një rritje prej 30%) dhe do të mbetet në një vijë të drejtë gjatë shtatë viteve, para se të bjerë në mënyrë progresive për të ardhur përsëri në shifrën fillestare nga fundi i periudhës së parashkimit (pak më pak në rastin e migracionit, pak më shumë kur nuk ka migracion). Këto ngjitje dhe zbritje pasqyrojnë drejtpërdrejt ndryshimet në madhësinë e grup-moshës kur zbresim përgjatë shkallës së moshës në piramidën e vizatur me të dhënat e regjistrimit të fundit; ka më shumë persona nga 10 deri në 15, të cilët do të hyjnë në forcën e punës gjatë periudhës 2006-2011, se sa në moshat më të reja dhe më të vjetra.

Në ekstremin tjetër të moshave aktive, numri i personave me moshë 60 vjeç na jep një ide për **largimet nga aktiviteti dhe hyrjen në pension**. Edhe këtu përsëri vetëm supozimet e migracionit kanë një farë ndikimi. Faktori vendimtar është madhësia e brezave (kohorteve) 40 deri në 60 në 2001, që do t'i japin fund veprimtarisë së tyre në vitet që do të vijnë.

Ata do të jenë rreth 25,000 çdo vit në fillim të periudhës dhe shifra do të rritet gradualisht nga viti 2008 deri në fund të periudhës së parashikimit. Në këtë vijë, do të ketë të paktën 40,000 (në rastin ku ka migracion) ose edhe 45,000 (në mungesë të tij). Këto janë rritje të mëdha, me 60% ose 80%.

Në dekadën e parë të parashikimit, hyrjet në moshat aktive çdo vit do t'i kalojnë daljet me të paktën 30,000. Në dekadën e dytë, do të ketë gjithnjë e më pak të porsaardhur dhe

gjithnjë e më shumë pensionistë të rinj. Teprica e të parëve ndaj të dytëve do të zhduket me shpejtësi dhe do të bjerë në 8,000. Dinamika e popullsisë aktive do të ulet me shpejtësi. Në të njëjtën kohë, grupi i pensionistëve, me moshë 60+ do të përballet me një numur anëtarësh të rinj që rritet me shpejtësi, të cilët do ta shtojnë shumë numrin e të moshuarve.

2.2.4 Një vështrim për përbërjen e ardhshme të moshës

Shenja të ndryshme të **plakjes së paevitueshme** do të fillojnë të shfaqen në një të ardhme të afërt në Shqipëri. Grupi i fëmijëve të vegjël do të pakësohet dhe po ashtu edhe numri i nxënësve, sidomos po që se lindshmëria bie me shpejtësi. Të moshuarit do të rriten në numër dhe në propocione, edhe kur përqindja e tyre ndaj popullsisë së përgjithshme do të mbetet e moderuar, sipas standarteve evropiane. Siç ndodh rëndom në këtë fazë të këtij procesi, numri i personave të grup-moshës së madhe të ndërmjetme, ku shumica janë ekonomikisht aktivë, do të rritet për një kohë, por kjo lëvizje do të ngadalësohet në mënyrë progresive.

Me afat të gjatë, pritet një plakje e theksuar që do të prekë të gjitha segmentet e piramidës së moshës, më pak fëmijë, më shumë të moshuar dhe një plakje e popullsisë aktive.

2.3. POPULLSIA NË RAJONE

2.3.1 Popullsia e përgjithshme dhe rritja e popullsisë


Shpërndarja rajonale e popullsisë shqiptare do të ndryshojë shumë gjatë dy dekadave të ardhshme, në rast se migracioni i brëndshëm i tanishëm do të ruhet në këtë nivel gjatë gjithë periudhës. Rrethet e Tiranës dhe të Durrësit do të tërheqin pothuaj të gjithë rritjen demografike, kurse popullsia në pjesën tjetër



Tabela 12. Projektionet e Popullsisë për Rajonet e Shqipërisë
Popullsia gjithsej çdo 5 vjet dhe shpërndarja sipas rajoneve

POPULLSIA GJITHSEJ (1 Janar)								
Rajonet	Veri		Qendër (pa T-D)		Jug		Tirana-Durrës	
Vitet	Numër	%	Numër	%	Numër	%	Numër	%
2001	371396	12.10%	990641	32.30%	1001264	32.70%	700017	22.90%
2006	366759	11.30%	1040137	32.00%	1010720	31.10%	828120	25.50%
2011	360546	10.50%	1086544	31.80%	1016994	29.70%	956393	28.00%
2016	352254	9.80%	1129517	31.50%	1018386	28.40%	1083997	30.20%
2021	340564	9.20%	1163330	31.30%	1009740	27.20%	1205074	32.40%

Figura 8: Projektionet e Popullsisë për Rajonet e Shqipërisë,
Popullsia gjithsej sipas supozimeve të ndryshme për migracionin



të vendit do të rrijë në vend ose do të pakësohet pak.

Është bërë një parashikim i vetëm për popullsinë, i cili ruan dallimet e lindshmërisë midis rajoneve, ashtu siç u matën ato në fillim të shekullit dhe migracionin e brëndshëm siç u mat në 2000-2002 (vdekshmëria mendohet të mos ndryshojë, lindshmëria të bjerë me ngadalë, kurse migracioni i jashtëm mendohet të jetë zero). Megjithatë, një përlogaritje reference ka përcaktuar se si do jetë drejtimi i popullsisë së rajoneve në rast se ndërpritet migracioni i brëndshëm. Qëllimi i vetëm është të ilustruhet rëndësia që merr lëvizja e këtyre personave në ndryshimet e ardhshme të popullsisë.

Popullsia në rrethet e Tiranës dhe të Durrësit do të rritet nga 700,000 në 1,200,000 në njëzet vjet. Kjo rritje prej 70% mund t'i atribuohet kryesisht vendosjes së të porsaardhurve nga pjesa tjetër e vendit; në mungesë të këtyre zhvendosjeve të popullsisë, popullsia në dy rrethet do të jetë vetëm 830,000 në 2021 (Figura 8 dhe Tabela 12).

Popullsia në Jug dhe në Qendër (me përjashtim të Tiranës dhe të Durrësit) ishte rreth 1 milion në 2001. Në mungesë të migracionit të brëndshëm, të dy këto qytete do të rriteshin deri në 1.2 milion, pak me pak se në Jug, pak me shumë se në Qendër, për shkak të një lindshmërie disi më të vogël në rajonin e parë. Gjithsesi, dallimi midis të dyve do të mbetet i vogël për shkak se edhe hendeku në lindshmëri është po ashtu i kufizuar. Migracioni i brëndshëm do të fusë një mospërputhje më substanciale: rritja e popullsisë në Jug do të jetë pothuaj e pakonsiderueshme, totali i saj do të qëndrojë rreth 1 milion, por jo në Qendër, ku migracioni është i vogël dhe ku popullsia do të arrijë rreth 1.2 milion në 2021.

Në Veri, lëvizja natyrore do të rezultojë në një rritje të konsiderueshme të popullsisë, për shkak të lindshmërisë ende të lartë. Në

mungesë të migracionit, numri i banorëve do të rritet me 40% nga 370,000 në 520,000 gjatë njëzet viteve. Por, gjithashtu, ky është rajoni me emigracionin më të madh krahasuar me pjesën tjetër të vendit. Në rast se ruhet në nivelin e tanishëm, ky migracion do të kundërbalancojë efektin e lindshmërisë së lartë dhe do të rezultojë në uljen e popullsisë në 340,000 që ishte në 2021.

Përqindja e popullsisë në rrethet e Tiranës dhe të Durrësit do të rritet në mënyrë të konsiderueshme, nga më pak se një e katërta në rreth një të tretën e popullsisë së të gjithë vendit. Rëndësia relative e secilit prej të tre rajoneve do të ulët: pak në Qendër, por shumë në Jug, por edhe më shumë në Veri. Më shumë se kurrë, popullsia e Shqipërisë do të përqëndrohet në pjesën qendrore të vendit.

2.3.2 Popullsia sipas moshës

Struktura e moshës në rajone do të tregojë lëvizjen drejt plakjes **që do të karakterizojë të gjithë vendin. Aty ku lindshmëria është më e madhe (Veri) popullsia do të mbetet më e re, ku është më e vogël (Jug), plakja do të jetë më e madhe. Por migracioni nuk do të ndikojë në strukturat e moshës ashtu si do të ndikojë në rritjen e popullsisë, duke krijuar kështu një hendek të madh midis Tiranës dhe Durrësit dhe pjesës tjetër të vendit.**

Diferencat në përbërjen e moshës së popullsisë së numëruar në rajonet në 2001 pasqyrojnë kryesisht dallimet në nivelet e lindshmërisë në të kaluarën dhe tani. Me një lindshmëri shumë më të lartë se mesatarja, rajoni i Veriut kishte një përqindje më të madhe fëmijësh dhe një përqindje më të ulët të të moshuarve. Jugu, jo vetëm kishte nivelet më të ulta të lindshmërisë, por edhe historinë më të gjatë të lindshmërisë së ulët, për qindje më të vogla të popullsisë nën moshën 15 vjeç kombinoheshin me për qindje relativisht të larta të personave me moshë 65+. (Figura 9 dhe Tabela 13)



Figura 9. Projektionet e Popullsisë për Rajonet e Shqipërisë, Piramidat e moshave në 2001 dhe 2021




Table 13. Projektionet e Popullsisë për Rajonet e Shqipërisë. Shpërndarja sipas grup-moshave të mëdha

Rajonet	Veri			Qendër (pa T-D)			Jug			Tirana-Durrësi		
	0-14	15-64	65+	0-14	15-64	65+	0-14	15-64	65+	0-14	15-64	65+
2001	34.80%	59.20%	6.00%	30.80%	62.30%	6.90%	27.80%	64.00%	8.20%	27.50%	64.80%	7.70%
2006	31.90%	61.30%	6.80%	26.80%	65.20%	8.00%	23.70%	66.60%	9.70%	25.00%	65.90%	9.10%
2011	29.80%	63.00%	7.20%	23.70%	67.20%	9.00%	21.50%	68.10%	10.50%	23.10%	66.90%	10.00%
2016	29.10%	63.50%	7.40%	22.40%	67.70%	9.80%	20.60%	68.00%	11.50%	22.20%	66.90%	10.90%
2021	28.00%	64.40%	7.60%	21.70%	67.50%	10.80%	20.10%	67.00%	12.90%	21.20%	66.80%	12.00%

Kudo, rënia e lindshmërisë do të vazhdojë krahas procesit të plakjes. Megjithatë, treguesit e rajonit të Veriut do të mbeten pas pjesës tjetër të vendit, në rast se nuk përshpejtohet rënia e lindshmërisë dhe sjelljet rajonale do të përafrohen me mesataren e vendit. Pas njëzet vjet mosrënie të lindshmërisë, piramida e moshës do të vazhdojë të ketë një bazë disi të gjerë në moshat shumë të reja. Forma do të mbetet padyshim e qartë në pjesën tjetër të vendit, me baza më të ngushta dhe me piramida më të pabarabarta, për shkak të ndikimit më të fortë të migracionit të jashtëm në vitet 90-të. Jugu dhe Tirana-Durrësi, po ashtu do të përjetojnë një rritje të konsiderueshme në përqindjen e personave me moshë të vjetër, por lëvizja do të mbetet e moderuar në bazë të supozimit të një rënie të ngadaltë të lindshmërisë në gjithë vendin.

Migracioni i brendshëm është menduar të jetë i shpërndarë në mënyrë të barabartë në të gjitha moshat, në propocion me popullsinë, siç provohet të ketë qenë në të kaluarën e afërt. Hipoteza nënkupton se migracioni, pavarësisht nga intensiteti i tij, nuk do të ketë ndonjë efekt në strukturën e moshës së popullsisë rajonale. Kjo është arsyeja pse piramidat e ardhshme të moshës nuk do të tregojnë ndonjë kontrast midis rajoneve me një humbje të madhe të emigrantëve dhe të rajoneve, të cilat do të presin të zhvendosurit e brendshëm. Për shembull, në 2021, piramida e moshës në Jug nuk do të jetë shumë e ndryshme nga ajo e rretheve të Tiranës dhe të Durrësit.

Një ngjashmëri e tillë, e cila mund të lexohet edhe në piramidën e moshës edhe në shpërndarjet e moshës në grup-moshat e mëdha, është shumë ndryshe nga konsideratat e mëparshme për tendencën e popullsisë së përgjithshme të rajoneve, kur Jugu (dhe Veriu) tregohen se rrinë në vend ose edhe se iu pakësohet numri, kurse Tirana dhe Durrësi do të kenë një rritje të madhe të numrit të popullsisë.

2.4 PËRZGJEDHJET NDËR GRUPET E PARASHIKIMEVE TË POPULLSISË

Në faqet që do të vijjnë, rezultatet e hollësishme të parashikimeve jepen në bazë të popullsisë së të gjithë vendit të klasifikuar sipas gjinisë dhe moshës (vitet njëshe të moshës ose grupet pesëvjeçare të moshës) për çdo 1 janar nga 2001 deri në 2021. Propozohen tetë grupe rezultatesh, në varësi të tendencave të ardhshme të vdekshmërisë, lindshmërisë dhe migracionit të jashtëm. Parashikimet e popullsisë rajonale jepen çdo pesë vjet sipas gjinisë dhe grup moshave pesëvjeçare, në një grup parashikimesh.

Çdo përdorues është i lirë të vendosë vetë për parashikimet që ai ose ajo do të përdorë. Megjithatë, disa udhëzime mund të jenë të dobishme, në bazë të asaj që kemi lexuar, ndërkohë, në këtë masë të madhe informacionesh... ose në dritën e arsyes dhe të përvojës.

2.4.1 Parashikimet e popullsisë kombëtare

Rreziqet e vdekshmërisë janë menduar të mbeten në nivelin e tyre të 2000-2001 ose të bien në të gjitha moshat, me qëllim që të arrijnë në vitin 2021 nivelin italian të 1997. Përzgjedhja e këtyre supozimeve është udhëhequr nga fakti se shkalla e vdekshmërisë në Shqipëri është edhe tani mjaft e favorshme dhe se nuk do të rritet shumë në të ardhmen. Gjithashtu është treguar se Shqipëria i takon sistemit mesdhetar, ku dieta është një mbrojtje kundër rreziqeve të vdekshmërisë, në veçanti në moshat më të vjetra, edhe kur shkalla e zhvillimit ekonomik është ende e ulët.



Rezultatet janë mjaft të ngushta, qoftë kur marrim parasysh parashikimet me vdekshmëri konstante, qoftë ato me rreziqe pak të reduktuara. Ndikimi ndaj shifrave të përgjithshme është shumë i vogël, kurse ai në strukturën e moshës është zero. Zgjedhja e një supozimi ndaj një tjetri është e parëndësishme. Në pjesën e tretë, botojmë rezultate plotësisht të hollësishme (pra, në vite njëshe të moshës) vetëm për **vdekshmërinë e pandryshueshme**. Parashikimet me rreziqe të reduktuara të vdekshmërisë botohen në bazë të grup-moshave pesëvjeçare.

Migracioni është faktori më i madh i panjohur. Pjesa më e madhe e lëvizjeve janë të padokumentuara. Ato janë ndoshta më të dobëta se sa në fund të viteve nëntëdhjetë, por sa njerëz vazhdojnë të mos largohen nga vendi dhe sa të tjerë po kthehen në vend? A e kompensojnë këto dy lëvizje njëra tjetrën dhe a do të kenë tendencë ta bëjnë një gjë të tillë në të ardhmen (pa migracion ose me emigracion prej 15,000 në vit). Shpërndarja e moshës të migrantëve është po ashtu e paditur: ata kanë qenë të rritur në moshë të re, me fëmijë të vegjël në lëvizjet masive pas 1995, por janë njëlloj të shpërndarë në gjitha moshat në lëvizjet e migrantëve të brendshëm që largohen nga rrethet e tyre për t'u mbledhur në Tiranë dhe në Durrës.

E vetmja zgjidhje është ndoshta të shihen rezultatet me ose pa migracion. Ka të ngjarë që zhvillimi ekonomik do të ishte pengesa më e efektshme kundër largimeve të mëdha dhe të zgjatura të shqiptarëve dhe se e ardhmja do të varet nga kushtet ekonomike në vend dhe në rajon.

Lindshmëria ka rënë me shpejtësi në Shqipëri që nga vitet 60, dhe kjo ka të ngjarë të ketë qenë rënia më e madhe në Evropë. Në 2001, gratë kanë pasur një mesatare prej 2.3 lindjesh, që mbetet shifra më e lartë në Europë në këtë periudhë me lindshmëri

shumë të ulët. Shifrat më të ulta të mundshme, nën 1.3 lindje për grua, janë ndonjëherë në vende pranë me Shqipërinë (në bregun e Mesdheut si në Itali, në ish Ballkanin socialist, si në Bullgari). Pjesë e rënies shpjegohet me modernizmin, një pjesë me kushtet e vështira ekonomike, në veçanti në vendet që po shkojnë drejt ekonomisë së tregut.

